

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6996  
E premte, 15 shtator 2023  
Çmimi 0.40

Osmani: Kosova e gatshme për zgjedhje të reja në veri, por duhet garanci nga ndërkombëtarët FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI DHE PRESIDENTI I SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ, ME NDËRMJETËSIMIN E BE-SË, JANË TAKUAR NË BRUKSEL FAQE 4-5

## TAKIMI KURTI - VUÇIQ PËRFUNDON PA SUKSES

- KURTI KRITIKON LAJÇAKUN: E KA CENUAR FUNKSIONIN E TIJ, POR UNË NUK E CENOJ KOSOVËN

- BORRELLI: KURTI NUK KA QENË I GATSHËM TË ECË PËRPARA PAS FILLIMIT TË NJË PROCESI TË BESUESHËM PËR THEMELIMIN E ASOCIACIONIT



Takimi në Bruksel ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka përfunduar pa sukses. Pas këtij takimi shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, ka thënë se Kurti nuk ka qenë i gatshëm për fillimin e procesit për themelimin e

Asociacionit. Borrelli ka thënë se Kurti ka insistuar të formalizohet njohja de-facto e Kosovës nga Serbia. Në linjë me Borrellin ka folur Vuçiqi. Ndërsa kryeministri Albin Kurti i ka akuzuar ndërmjetësuesit, sidomos Mirosllav Lajçakun, i cili, sipas tij, ka pranuar kushtëzimin e

Serbisë për Asociacionin. "Është për të ardhur keq që Lajçaku e ka pranuar një kushtëzim të tillë nga Serbia dhe atë e ka bërë në cenim të funksionit të tij si lehtësues, por unë nuk mund ta pranoj një gjë të tillë duke cenuar Kosovën", ka thënë Kurti

## VETERANËT E UÇK-së SOT PROTESTOJNË KUNDËR ZPS-së DHE EULEX-it FAQE 3



## DËSHMITARI BRITANIK NË HAGË: SHQIPTARËT KISHIN KARAKTER TË FORTË KOMBËTAR DHE NDJESI TË LARTË PATRIOTIKE FAQE 3



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fac: +389 44 487 200  
Mbc: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## BUXHETI I PRISHTINËS PËR VITIN 2024 DO TË JETË MBI 123 MILIONË EURO F. 8

"LIBERALIZIMI I VIZAVE DO TË KETË EFEKT NË EKONOMINË E KOSOVËS" F. 8

## SPORT



RUMANIA PËRBALLET ME GJASHTË AKUZAT, UEFA NIS HETIMET F. 12

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Parlamenti Evropian: Lukashenko, bashkëpunëtor në krimet e Putinit

STRASBURG, 14 SHTATOR - Parlamenti Evropian (PE) ka miratuar një rezolutë që e cilëson udhëheqësin bjellorus Aleksandër Lukashenko “bashkëpunëtor” i “krimeve” të Rusisë. Në një raport mbi marrëdhëniet e tij me Bjellorusinë, PE-ja ka thënë se regjimi i Lukashenkos kishte

mundësuar “luftën e pajustificuar të agresionit” të Moskës kundër Ukrainës, shkruan “Sky News”. Prandaj, sipas PE-së, regjimi mban përgjegjësi “për shkatërrimin dhe dëmin e shkaktuar”, thuhet në rezolutë. Ky raport u bënë thirrje

institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian (BE) dhe vendeve anëtare t'i ndjekin penalisht zyrtarët bjellorusë “të cilët janë bashkëpunëtorë në krimet e agresionit, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e gjenocidit të kryera kundër Ukrainës”.



## Aksioni antidrogë në Shqipëri, Rama: 233 shpërndarës të drogës të arrestuar dhe 23 rrjete kriminale të shkatërruara

TRANË, 14 SHTATOR - Një operacion i madh kombëtar antidrogë është zhvilluar nga toka dhe ajri në Tiranë dhe gjithë Shqipërinë. Në lidhje me këtë aksion ka hollësi kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili ka deklaruar se 233 persona janë arrestuar, pasi dyshohen se shpërndanin drogë te nxënësit e shkollave. “Superoperacioni i Policisë së Shtetit u ka hedhur prangat gjatë gjithë natës së mbrëmshme dhe deri në orët e para të mëngjesit 233 shpërndarësve të drogës të cilët kishin në shënjestër të veprimtarisë së tyre kriminale nxënësit e shkollave. Pas një

hetimi të imtësishëm e mbledhjeje të provave në të gjitha qarqet e vendit janë shkatërruar 23 rrjete kriminale dhe është neutralizuar një burim i rrezikshëm dëmi për shëndetin e më të rinjve, ndërkohë që kjo është një tjetër provë e ngritjes së luftës kundër krimit të organizuar në një nivel të ri”, ka thënë Rama, duke e vlerësuar lart punën e policisë shqiptare. “Një duartrokitje e fortë për Policinë e Shtetit, e cila dita-ditës po rrit forcën goditëse ndaj keqbërësve të çdo lloji dhe po afirmon fuqinë e saj si garante e rendit, sigurisë e qetësisë publike në çdo komunitet”, ka thënë Rama.



## Franca regjistroi 400 vdekje të lidhura me të nxehtin në gusht



PARIS, 14 SHTATOR - Përgjatë valës së të nxehtit në gusht, autoritetet në Francë i kanë regjistruar gati 400 viktima të lidhura me motin e nxehtë, ka thënë Autoriteti i Shëndetit Publik i këtij vendi. Personat mbi moshën 75-vjeçare janë më të prekurit, është thënë në raportin e publikuar në Paris. Përgjatë valës së tretë të të nxehtit në Francë, në periudhën 11-26 gusht, numri i vdekjeve është rritur për 5.4 për qind më shumë në krahasim me javët e njëjta të

viteve të fundit. Përgjatë kësaj periudhe temperaturat në Francë janë rritur në 42 gradë celsius në disa rajone. Nëse njerëzit vdesin më shumë në javët me temperatura të larta, në krahasim me javët e njëjta të viteve të kaluara, rritja e shkallës së vdekshmërisë vlerësohet se është shkaktuar nga i nxehti. Megjithatë, në raport është përmendur se rezultatet janë preliminare. Ndonëse shumica e vdekjeve besohet se janë shkaktuar për shkak të gjendjeve

paraprake, nxehtësia mund ta ketë përkeqësuar situatën. Në raport është përmendur se gjetjet tregojnë se i nxehti përbën rrezik shëndetësor, madje edhe jashtë periudhave të të nxehtit, prandaj duhen zbatuar masa parandaluese për zvogëlim të ndikimit të të nxehtit në popullsi. Prej fillimit të muajit korrik bota është përballur me temperatura tejet të larta. Në disa studime është thënë se një mot i tillë do të ishte gati i pamundshëm pa ndryshimet klimatike të nxitura nga njeriu.

## Berlini binjakëzohet me Kievin

BERLIN, 14 SHTATOR - Kryetarët e Berlinit dhe Kievit pritet ta nënshkruajnë të enjten një marrëveshje që i binjakëzon dy qytetet. Kryetari i kryeqytetit ukrainas, Vitali Klitschko, do të udhëtojë drejt kryeqytetit gjerman, Berlinit, për ta finalizuar paktin. Kryetari i Berlinit, Kai Wegner, do ta takojë Klitschkon në portën Brandenburg në pasditen e së enjtes, më pas të dy do të nisen drejt Sallës së

Kuqe të Qytetit. Palët janë marrë vesh për binjakëzim më herët gjatë këtij viti. Berlini e sheh këtë vendim si shenjë solidariteti me Ukrainën që po përballlet me pushtimin rus prej shkurtit të vitit 2022. Sipas autoriteteve të Berlinit, kryeqyteti gjerman është i binjakëzuar edhe me 17 qytete të tjera. Partneriteti i qytetit gjerman me Moskën, përmes një marrëveshjeje të

nënshkruar më 1991, është pezulluar për shkak të luftës në Ukrainë. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Përfundimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke e goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



# Dëshmitari britanik në Hagë: Shqiptarët kishin karakter të fortë kombëtar dhe ndjesi të lartë patriotike

HAGË, 14 SHTATOR - Në Gjykatën Speciale në Hagë, në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, dëshmitari Douglas Young, ish-oficer i ushtrisë britanike, ka thënë se shqiptarët kishin karakter të fortë kombëtar dhe ndjesi të lartë patriotike. Këtë deklaram ai e ka bërë duke u përgjigjur në kundërpëpyetjet e avokatit të Rexhep Selimit, Geoffrey Roberts. “Nga marrëdhëniet e mia të zgjeruara me shqiptarët dhe veteranët e UÇK-së ishte pjesërisht nga psikologjia kombëtare dhe karakteri kombëtar që ata dëshironin që forca e tyre të shihej si e nderuar dhe përfaqësuese e fitores kombëtare. Dua të them se kishin karakter të fortë kombëtar dhe ndjesi të lartë patriotike”, ka thënë dëshmitari Young. Këtë e ka thënë si arsytim se pse kishte thënë se pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dëshironin të shiheshin si ushtri e organizuar. Kurse, si arsye të parë, ai ka thënë se kishte që UÇK-ja të prezantohet në mënyrë sa më të mirë para

organizatave ndërkombëtare në mënyrë që të demonstronte legjitimitet dhe ta ekzagjeronte nivelin e organizimit në krahasim me çka ishte në realitet për t'i inkurajuar shtetet ta ndihmonin UÇK-në. Po ashtu, dëshmitari Young ka treguar se sa i përket komunikimit kishte qenë dëshmitar se ushtarët nuk kishin pasur radiolidhje. Ai ka thënë se ushtarët e UÇK-së kanë shkrepur plumba në ajër dhe me armë pa pushim për t'ia dhënë udhëzimin komandant Drinit për armëpushim, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Lidhur me pikat e kontrollit, ai ka thënë se personalisht kishte kaluar në dy prej tyre, por se kishte parë edhe të tjera. Në anën tjetër, i pyetur për deklaramin e mëparshëm se kolegu i tij kishte takuar “10-shin” (Rexhep Selimi), ai ka thënë se nuk kishte qenë në njohuri se kush ishte apo nëse ishte një person apo një departament.

Duke i lexuar pjesë të deklaramit të dëshmitarit në TPNJ është thënë se kishte deklaruar se kolegu i tij e kishte njohur “10-



shin” si përfaqësuesin e shefit të inteligjencës apo se në raportin për incidentin të misionit verifikues kishte thënë se kolegu ka njohur shefin e operacioneve sekrete të UÇK-së. Dëshmitari sërish është pyetur për takimin e tij me Fatmir Limaj, ku ka dhënë detaje se fillimisht kishte takim me Skenderin, i cili, i udhëzuar nga komandant Drini, i kishte çuar në vendtakim në Tërpezë. Ai ka thënë se në atë takim i njëjti kishte qenë me qëndrimin se komandant Drini u kishte dhënë qasje të personi në fjalë, por se aty kishte qenë i vetëdijshëm se

kishte të bënte me një nivel më të lartë dhe mbi komandant Drinin.

Young ka thënë se para se të largohej nga takimi, kolegët e tij e kishin informuar se personi që ka takuar ishte Fatmir Limaj - komandant “Çeliku”. I njëjti ka sqaruar se ai takim ka qenë me mosmarrëveshje pasi, sipas tij, Limaj i kishte thënë se Youngut ka simpati ndaj serbëve dhe kishte përmendur personin e zhdukur andaj, sipas tij, nuk ishte e kuptueshme që të kthehej nga makina për ta verifikuar identitetin e tij. Sipas tij,

shqetësues ishte edhe fakti se po përballej me një person që nuk ishte nën kontrollin e komandant Drinit dhe se ai ishte ndër i pasigurt. Dëshmitari ka thënë se ky person po fliste në emër të niveleve më të larta dhe qartësisht u kishte thënë se personi tanimë është nën kontroll të Shtabit të Përgjithshëm dhe se, sipas tij, i binte se negociatat e deritanishme me komandant Drinin nuk kishin vlerë.

Ndërsa i pyetur nëse asnjëherë s'kishte pasur dyshime se ai ishte personi që i ishte thënë se ishte, dëshmitari ka thënë se ai kishte pasur njohuri të mëparshme për llojet e operacioneve që personi ishte i përfshirë më parë dhe se emri përputhej me paraqitjen e tij.

Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Katërshja e UÇK-së është deklaruar e pajafshme në raport me akuzat me të cilat është ngarkuar nga ZPS-ja.

## Veteranët e UÇK-së sot protestojnë kundër ZPŞ-së dhe EULEX-it



PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kohën e fundit janë bërë të shpeshta bastisjet e Gjykatës Speciale në shtëpitë e familjarëve të luftëtarëve të UÇK-së. Një bastisje e tillë ka ndodhur edhe të enjten në shtëpinë e Behar Berishës, i cili ka qenë bashkëluftëtar i Salih Mustafës - Calit. Lidhur me këtë bastisje, ka

reaguar ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVL-UÇK-së, Faton Klinaku, duke kritikuar EULEX-in dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Hagë. Ai ka thënë se me veprimet e fundit këto institucione kanë shqetësuar familjet e shumë veteranëve të UÇK-së.

Në këtë kontekst, Klinaku ka njoftuar se sot (e premte) do të protestohet kundër EULEX-it dhe Gjykatës Speciale. Ai ka

treguar se protesta do të mbahet te selia e këtyre institucioneve në Fushë-Kosovë, nga ora 12:00. “Jeni dëshmitarë që Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë dhe EULEX-i janë, duke i shqetësuar familjet e bashkëluftëtarëve tanë dhe familjet e dëshmorëve, duke dërguar pa paralajmërim njerëz të panjohur e me kapela në kokë, për gjoja intervistime e duke ua konfiskuar edhe telefonat e tyre

personal. Kjo gjë kështu, siç po bëjnë këta të panjohur për ne, po bëhet në shtetin tonë sikur dikur në kohën e pushtuesit, dhe institucionet tona vetëm po heshtin. Prandaj, duke pasur parasysh këtë, ne thërrasim protestë kundër ZPS-së dhe EULEX-it, te selia e tyre në Fushë Kosovë, nesër me datë 15 shtator 2023, ora 12:00. Ju ftojme që të merrni pjesë në protestë”, ka shkruar Klinaku në “Facebook”.

Me urdhër të Zyrës së Prokurorit është bastisur banesa e familjarëve të heronjve Fahri dhe Bahri Fazliut. Po ashtu, janë ndaluar për disa orë edhe Rustem Mustafa dhe Nait Hasani. Krejt këto bastisje dhe ndalime janë duke ndodhur në kohën kur është duke u zhvilluar procesi gjyqësor në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.



KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI DHE PRESIDENTI I SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ, ME NDËRMJETËSIMIN E BE-SË, JANË TAKUAR NË BRUKSEL

## Takimi Kurti - Vuçiq përfundon pa sukses

**- Kurti kritikon Lajçakun: E ka cenuar funksionin e tij, por unë nuk e cenoj Kosovën**

**- Borrelli: Kurti nuk ka qenë i gatshëm të ecë përpara pas fillimit të një procesi të besueshëm për themelimin e Asociacionit**

Takimi në Bruksel ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka përfunduar pa sukses. Pas këtij takimi shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, ka thënë se Kurti nuk ka qenë i gatshëm për fillimin e procesit për themelimin e Asociacionit. Borrelli ka thënë se Kurti ka insistuar të formalizohet njohja de-fakto e Kosovës nga Serbia. Në linjë me Borrellin ka folur Vuçiqi. Ndërsa kryeministri Albin Kurti i ka akuzuar ndërmjetësuesit, sidomos Miroslav Lajçakun, i cili, sipas tij, ka pranuar kushtëzimin e Serbisë për Asociacionin. “Është për të ardhur keq që Lajçaku e ka pranuar një kushtëzim të tillë nga Serbia dhe atë e ka bërë në cenim të funksionit të tij si lehtësues, por unë nuk mund ta pranoj një gjë të tillë duke cenuar Kosovën”, ka thënë Kurti

**EPOKA E RE**

**Lirim GECI**

**PRISHTINË, 14 SHTATOR** - Kryeministri i Kosovës dhe presidenti i Serbisë janë takuar të enjten në Bruksel në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE). Fillimisht Kurti dhe Vuçiqi janë pritur në takime të ndara nga kryediplomati i BE-së, Josep Borrell dhe emisari për dialogun, Miroslav Lajçak, për të vazhduar pastaj me takimin trepalësh, i cili ka përfunduar pa ndonjë rezultat. “Sot me kryeministrin Kurti dhe presidentin Vuçiq kam tentuar të gjejmë zgjidhje për një rrugë përpara bazuar në propozimin tonë. Fatkeqësisht, pas një takimi të gjatë, kryeministri Kurti nuk ka qenë

i gatshëm të ecë përpara për fillimin e një procesi të besueshëm për themelimin e Asociacionit (të Komunave me Shumicë serbe në Kosovë). Në vend të tij, ai ka insistuar të formalizohet njohja de facto si hap i parë”, ka thënë Borrelli në një konferencë për medie. Ai ka bërë me dije se janë përpjekur të gjejnë një zgjidhje por, sipas tij, ka qenë e pamundur të thyhen dallimet në mes të palëve. “Jemi përpjekur shumë por, për fat të keq, sot nuk ka qenë e mundur të thyhen dallimet”, ka thënë ai, duke shtuar se Vuçiqi e ka pranuar propozimin e BE-së. Borrelli ka sqaruar se propozim i bllokut evropian është që marrëveshja për normalizim marrëdhëniesh të zbatohet nga të

dyja palët paralelisht. “Ky ka qenë kompromisi më i mirë që kemi mundur të ofrojmë”, ka thënë Borrelli. Ai ka thënë se edhe ShBA-ja është duke e mbështetur këtë propozim të BE-së.

Kryediplomati evropian ka thënë, po ashtu, se nuk ka përparim për shtensionimin e situatë në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe. “Disa hapa janë ndërmarrë nga Kosova dhe ne i mirëpresim, por ajo nuk e ka përbushur kërkesën e bërë për shtensionim të plotë”, ka thënë

Borrelli.

Në linjë me Borrellin ka folur edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ai në konferencë për medie ka thënë se bisedimet me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, kanë përfunduar pa sukses. Ai ka thënë se Kurti e ka “refuzuar propozimin evropian”. “Ne të gjithë i kemi propozimet tona. Shqiptarët i kanë të vetat, ne i kemi tonat. Në fund ne si Serbi e kemi pranuar propozimin e kompromisit të BE-së. Kurti nuk ka dashur ta pranojë. Takimi ka përfunduar”, ka thënë

Vuçiqi në një deklaratë për gazetarë. I pyetur nga gazetarët në Bruksel se cili ishte propozimi i BE-së, ai ka thënë se flitet për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. “Nëse do të konstatojmë se procesi është i besueshëm dhe se po shkojmë drejt formimit të Asociacionit të Komunave (me Shumicë) Serbe, ne paralelisht do të nisim me obligimet tona. Por, pala tjetër nuk ka pranuar”, ka thënë Vuçiqi, duke shtuar se Kurti është duke iu shmangur themelimit të Asociacionit. “Është e qartë se Kurti,

## Kurti kritikon Lajçakun: E ka cenuar funksionin e tij, por unë nuk e cenoj Kosovën

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kam folur pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, mbajtur në Bruksel me ndërmjetësimin e Josep Borrellit dhe Miroslav Lajçakut. Kurti ka thënë se në këtë takim ka propozuar një udhërrëfyes të sekuencuar për zbatimin e marrëveshjes së Brukselit dhe asaj të Ohrit.

Kurti ka thënë se Vuçiqi nuk ka dhënë asnjë propozim dhe takimi ka përfunduar pa rezultat. Në këtë drejtim, Kurti ka theksuar se nuk ka mundur të ketë kompromis pasi, sipas tij, nuk mund të ketë kompromis midis propozimit me të sekuencuar dhe kushtëzimit të vjetër - themelimit të Asociacionit. “Kur unë kërkova që ta shoh propozimin që ka dhënë Serbia, sepse më tha që ka një të tillë, ndërmjetësi nuk ishte në gjendje ta sjellë dhe vetëm pas përfundimit të takimit m’u dha njëdyfaqësh në anglisht dhe cirilike që paraqet një dokument të vjetër, së paku gjashtë muaj, që do të thotë se nuk



mund të jetë udhërrëfyes i sekuencuar i palës serbe, por ishte dokument i kushtëzimit të Serbisë që njëherë duhet të zbatohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, pastaj mund të kalojmë në marrëveshjen bazë”, ka thënë Kurti. Më tutje, ai ka thënë se i është dashur t’ua thoshte Borrellit dhe Lajçakut se nuk janë në prillin e vitit 2013 kur në dhomë ishin Catherine Ashton, Robert Copper, Hashim Thaçi dhe Ivica Dačić. “Neni 10 i marrëveshjes bazike thotë që duhet të zbatohen të

gjitha marrëveshjet të cilat janë të obligueshme e valide e që janë 39 sosh. Nuk mund të përzgjidhet vetëm një e tillë e të vendoset sikur qerrja para kuajve. Pra, një kushtëzim të tillë s’e kam pranuar”, ka thënë Kurti, duke adresuar kritika në drejtim të Lajçakut. “Është për të ardhur keq që Lajçaku e ka pranuar një kushtëzim të tillë nga Serbia dhe atë e ka bërë në cenim të funksionit të tij si lehtësues, por unë nuk mund ta pranoj një gjë të tillë duke cenuar Kosovën. Pra, edhe këtë dokumentin tjetër që është më i vjetër se 6 muaj, që paraqet dokumentin e kushtëzimit të Serbisë, që njëherë Asociacioni e pastaj shohim. Nuk kemi qenë në dijeni që ka një dokument të tillë. Nuk mund të quhet propozim, por është kushtëzim”, ka thënë Kurti. Shefi i qeverisë ka thënë se është për të ardhur keq që pikërisht kur është konstruktiv, shkaktohet një lloj nervoze në dhomë dhe vështirësohet dialogu.

## PDK-ja dhe AAK-ja kërkojnë zgjedhje të reja

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kuvendi i Kosovës të enjten ka nisur sesionin vjeshtor të punës. As në seancën e parë të këtij sesioni nuk kanë munguar kritikën e opozitës për pushtetin dhe kërkesa për zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka kërkuar që të mos blihet kohë, por vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Hoxhaj ka thënë se qeveria Kurti nuk ka guxim të marrë vendime të mëdha për Kosovën. Hoxhaj ka kërkuar nga deputetët e pushtetit që ta ndihmojnë opozitën për shpërndarjen e Kuvendit dhe shkuarjen në zgjedhje. "Ky vend ka mbetur pa lidhshmëri për të marrë vendime të mëdha. Ftoj shumicën parlamentare dhe krejt deputetët që e shohin interesin e Kosovës para interesit individual, se në fund të ditës na kur vijmë në

këtë institucion të nderuar e reflektojmë ndërgjegjen tonë, jo vetëm qëllimet tona, i ftoj të gjithë deputetët e shumicës dhe të opozitës ta shpërndajmë këtë Kuvend. Neve na duhet një qeveri e re. Na duhet një lidhshmëri. Na duhet një mandat i ri i këtij institucioni dhe i këtij Kuvendi me qëllim që Kosovën ta kthejmë te parimet kyçe të dialogut. Dhe parimet kyçe të dialogut janë marrëveshja obliguese ligjore jobazike, marrëveshje finale jo të përkohshme, marrëveshje për njohje të ndërsjellë dhe jo marrëveshje e cila është mosmarrëveshje", ka thënë Hoxhaj, duke shprehur skeptikizëm për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë. "Dhe këtë e thamë për një arsye. Këtë e thamë se e kam bindjen që procesi ku është Kosova unë nuk pres personalisht jo më 2023-2024, por nuk pres për një kohë të



gjatë të arrijmë ndonjë marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë për njohje të ndërsjellë", ka thënë Hoxhaj. Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se dialogu dhe qeverisja në Kosovë

janë në rrugë të gabuar. Ai ka theksuar se kjo rrugë e gabuar po i shkakton humbje dhe goditje. "Dialogu dhe qeverisja në Kosovë janë në rrugë të gabuar që po i shkakton humbje dhe goditje Kosovës. Nëse dikush shpreson që Kurti dhe qeveria Kurti ta

nxjerrë Kosovën nga sanksionet, do të dalë gabim", ka thënë Haradinaj në Kuvendin e Kosovës.

Në këtë kontekst, Haradinaj ka kërkuar që të ndalet Kurti dhe vendi të shkojë në zgjedhje. "Besoj që është detyrë e Kuvendit ta nxjerrë qeverinë Kurti dhe Albin Kurtin nga drejtimi i gabuar. Detyrë e të gjithë deputetëve dhe jo vetëm e atyre opozitarë. Besoj që ne si Kuvend duhet t'i marrim përgjegjësitë. Ne e kemi votuar, Kuvendi e ka votuar qeverinë, qytetarët i kanë votuar të zgjedhurit e të zgjedhurit qeverinë, e ne që i kemi dhënë besimin e në këtë rast shumica, ju lus shqyrtojeni a është në rregull të vazhdojmë një drejtim siç e kemi në vend apo të gjithë ne ta ndihmojmë Kosovën, ta ndihmojmë Kurtin me mocion, pra ta shkarkojmë qeverinë Kurti", ka thënë Haradinaj.

## Osmani: Kosova e gatshme për zgjedhje të reja në veri, por duhet garanci nga ndërkombëtarët

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në një intervistë për "Politico", ka thënë se ajo e ka bërë të qartë qysh më 1 qershor se Kosova është e gatshme të organizojë zgjedhje të reja në katër komunat në veri. Por, Osmani ka thënë se duhen ndërkombëtarët të përkujdesen që të mos lejojnë presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të ndërhyjë sërish në zgjedhjet e një vendi tjetër.

"Jemi të gatshëm t'i mbajmë zgjedhjet. Problemi është se komuniteti serb që jeton në veri të Kosovës, që është vetëm një e treta e të gjithë serbëve që jetojnë në Kosovë, po frikësohet nga njerëzit që paguhen, përkrahen dhe nxiten nga vetë presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe nga Serbia. Atyre u bëhet presion të mos marrin pjesë në zgjedhje. Ne ende nuk po shohim lëvizje ku Vuçiqi do të ndalojë së ndërhyri në zgjedhjet e një shteti tjetër", ka deklaruar Osmani.

Ajo ka thënë se bojkoti i zgjedhjeve



në veri nuk ishte vullnetar, por u bë shkak i presionit që po i bëhej popullatës lokale në veri. Ajo ka thënë se ka pasur raste që serbët që kanë dashur të votojnë janë rrahur apo kidnapuar nga njerëz të shërbimit sekret të Serbisë që drejtohet nga Aleksandër Vulin, një njeri që gjendet në listën e zezë të ShBA-së.

Osmani ka thënë se duhet përkujdesur që çdo gjë të bëhet në koordinim të plotë me partnerët ndërkombëtarë e me aleatët, që të

evitohen tensionet. "Tensionet nuk i ndihmojnë askujt, i bëjnë njerëzit të ndihen të pasigurt, largon investuesit potencialë nga vendi ynë, ndonëse Kosova është shtet shumë i sigurt. Po ashtu, tensionet u marrin aq shumë energji institucioneve, në vend se të merremi me reformim të sistemit të arsimit, shëndetësisë e të krijojmë vende pune. Historia e Kosovës është histori e aksioneve të përbashkëta. Kemi qenë gjithmonë të suksesshëm kur kemi punuar së

bashku me partnerë dhe aleatë", ka theksuar Osmani.

Osmani ka thënë se BE-ja duhet t'i përshejtojnë punët. Ajo ka shtuar se për Kosovën anëtarësimi në BE është prioritet institucional dhe vullnet i popullit. "Mbi 93 për qind e popullatës sonë është për rrugën e integritimit në BE. Por, nuk është vetëm kjo. Ne besojmë se është rruga e vetme që sjell prosperitet, zhvillim ekonomik, paqe të qëndrueshme dhe stabilitet. Dhe për një rajon që ka kaluar aq shumë në të kaluarën, sigurimi i paqes, që më pas hap rrugën e prosperitetit, është esencial", ka deklaruar Osmani. Ajo ka shtuar se anëtarësimi i Ballkanit Perëndimor në BE do të krijonte më tepër stabilitet dhe paqe. Presidentja e Kosovës ka thënë se është e vështirë të mos ketë ndjenjë të padurimit me proceset e gjata eurointegruese. Ajo ka përmendur edhe rastin e liberalizimit të vizave për Kosovën. "Është e vështirë të mos bëhesh i padurueshëm, veçanërisht kur të

kërkohej të kompletosh detyra shumë konkrete dhe e bën çdo gjë që të kërkohet dhe nuk ndodh asgjë. Vetëm merrni procesin e liberalizimit të vizave, që të flasim teknikisht është ndryshe nga rruga e integritimit, por është pjesë e asaj ndjesie që je pjesë e familjes evropiane. Ne kemi kompletuar të gjitha kriteret. Në fakt, dyfish më tepër kriteret krahasuar me çdo shtet tjetër në rajon dhe atë pesë vjet para se ta marrim vendimin për liberalizimin. Kështu që për pesë vjet vetëm kemi pritur aty dhe asnjë nuk ka qenë në gjendje të na japë arsye pse procesi është vonuar. Mund të imagjoni se për diçka aq bazike, siç është liria e lëvizjes, edhe pas kompletimit të gati 100 kriterëve, ata nuk na dhanë vendimin deri së fundi", ka thënë Osmani. Ajo ka theksuar se nuk e sheh problem dhënien e statusit të kandidatit për Ukrainën dhe Moldavinë. Osmani ka theksuar se nuk mendon që anëtarësimi i një shteti në BE do ta bllokoi një shtet tjetër.

thjesht, i shmanget formimit të Asociacionit. Ky është thelbi i gjithçkaje", ka thënë Vuçiqi.

Për formimin e këtij asociacioni Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje qysh në vitin 2013, por ajo nuk është zbatuar kurrë për shkak të shqetësimeve të shprehura në Prishtinë në lidhje me ndikimin që do të kishte ky asociacion në funksionalitetin e shtetit. Marrë parasysh se nuk ka marrëveshje, një gjë e tillë "çon vetëm në probleme më të mëdha", ka thënë Vuçiqi, duke shtuar se bisedimet duhet të vazhdojnë.

Presidenti serb ka thënë se në takim është diskutuar edhe për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe. Ai ka thënë se nëse kryetarët shqiptarë të komunave atje japin dorëheqje, ai "do të japë gjithçka nga vetja" që komuniteti serb të marrë pjesë në procesin e ri zgjedhor, por ka vënë

në dukje se nuk mund të premtojë në emër të tij. "Para së gjithash, jam i shqetësuar. Nën dy, nuk jam i pakënaqur - së paku, jam i kënaqur që Serbia ka treguar konstruktivitetin e saj, përgjegjësinë dhe vullnetin për t'iu qasur zgjidhjeve të kompromisit... Dhe, nën tre, jam edhe më i shqetësuar për pozitën e popullit serb në Kosovë, pas gjithçkaje që pashë dhe dëgjova sot", ka thënë Vuçiqi, duke shtuar se, në dy muajt e fundit, në Kosovë është rritur numri i incidenteve. Ai nuk ka specifikuar më shumë, por ka thënë se sigurisht pret reagimin e BE-së.

Takimi në Bruksel është zhvilluar në kohën e tensioneve të larta në veri të Kosovës, ku serbët janë shumicë. Situata atje është acaruar qysh nga fundi i majit. Atëkohë grupe serbësh kanë nisur protestat për ta kundërshtuar vendosjen e kryetarëve shqiptarë - nën përcjelljen e policisë - në zyrat e

komunave në veri.

Këta kryetarë kanë dalë nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të prillit që janë mbajtur në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq, por që janë bojkotuar nga popullata lokale serbe. Protestat në zonë janë shndërruar disa herë në përleshje të dhunshme - më të rëndat kanë qenë më 29 maj, kur dhjetëra ushtarë të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, kanë mbetur të plagosur. Duke e bërë përgjegjëse Qeverinë e Kosovës për situatën e krijuar, Bashkimi Evropian ka kërkuar prej tij t'i ulë tensionet duke i pezulluar operacionet policore në veri, duke i zhvendosur kryetarët e komunave në zyra alternative dhe duke shpallur zgjedhje të reja.

Deri më tash Qeveria e Kosovës ka përgjysmuar praninë e njërive policore në ndërtesat komunale në veri dhe ka shprehur gatishmëri për organizimin e zgjedhjeve të

reja. Për këtë qëllim ajo ka nxjerrë edhe një udhëzim administrativ, por që, sipas njohësve të çështjeve zgjedhore, ai vështirë se çon në proces të ri zgjedhor.

I dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, i cili vazhdimisht ka bërë thirrje për shtensionimin e situatës në veri, ka thënë në një intervistë për "Zërin e Amerikës" se "rruga më e shpejtë dhe më e lehtë për zgjedhjet e reja" do të ishte "nëse kryetarët e tanishëm shqiptarë japin dorëheqje". Por, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, Elbert Krasniqi, ka thënë se një veprim i tillë është "kërkesë vetëm e Beogradit".

Tensionet në veri e kanë bërë Kosovën subjekt të masave ndëshkuese edhe nga BE-ja, edhe nga ShBA-ja, pasi e kanë fajësuar për moskoordinim të veprimeve me to.

Kosova, e cila ka shpallur

pavarësinë në vitin 2008 dhe Serbia që vazhdon ta kundërshtojë atë, janë të angazhuara në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve qysh nga viti 2011. Me ndërmjetësimin e BE-së dhe me mbështetjen e ShBA-së, bisedimet kanë nisur fillimisht për çështje teknike, për të kaluar pastaj në nivel politik. Palët kanë arritur dhjetëra marrëveshje - nga lëvizja e lirë deri te çështja e të zhdururve nga lufta e viteve 1998/99 - por shumë prej tyre nuk janë zbatuar. Bashkimi Evropian ka kërkuar vazhdimisht nga Kosova dhe Serbia të zbatojnë gjithçka që janë pajtuar. Normalizimi i marrëdhënieve, njëherësh, është kusht për të dyja vendet të përparojnë në procesin e integritimit në Bashkimi Evropian. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE vitin e kaluar, ndërsa Serbia është vend kandidat që nga viti 2012.

## Ushtarët e FSK-së përfunduan kursin e forcave speciale në Republikën e Shqipërisë

TIJANË, 14 SHTATOR - Në kuadër të bashkëpunimit që ka Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh), një kontingjent i FSK-së ka realizuar trajnimin për forcat speciale. Në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale të FARSh-it të enjten

është zhvilluar ceremonia e përfundimit të këtij kursi. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralbrigade Ilir Xhebeqia, ushtarakë të lartë të FARSh-it, përfaqësues nga FSK-ja dhe miq dhe familjarë të kursantëve. “Në kuadër të ceremonisë të pranishmit kanë

parë nga afër një demonstrim stërvitor të përgatitur nga kursantët duke kryer veprime taktike si: luftim i afërt, goditje objekti, qitje ndaj objektivave të lëvizshme, qitje me precize, qitje me pengesa, qitje me snajper etj.”, ka njoftuar FSK-ja. Ky kurs ka përgatitur kursantët për operatorë të forcave

speciale me të gjitha aftësitë taktike dhe psikologjike, profesionale, drejtuese dhe luftarake për të qenë të suksesshëm në të gjithë spektrin e gjerë të operacioneve speciale. Kursi i Forcave Speciale është zhvilluar për një periudhë gjashtëmujore me kursantë



nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

## Aktakuzë ndaj dy serbëve për dhunimin e një gruaje shqiptare gjatë luftës



PRISHTINË, 14 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur të enjten aktakuzë kundër dy të pandehurve serbë me inicialet I. R. dhe D. D. për veprën penale të dhunimit seksual gjatë luftës në Kosovë. “Si pjesëtarë të forcave policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, gjatë një sulmi të gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, kundër popullatës civile shqiptare në territorin e komunës së Prishtinës, me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, kanë kryer dhunim seksual ndaj

gruas së nacionalitetit shqiptar”, ka njoftuar PSRK-ja.

Prokuroria ka bërë me dije se të akuzuarit kanë kryer veprën penale “krimet e luftës kundër popullsisë civile”. “Me këtë rast viktimë pësoi lëndime të rënda fizike në trup si dhe trauma të përhershme psikike”, ka njoftuar PSRK-ja.

Prokuroria Speciale i ka kërkuar Gjykatës Themelore në Prishtinë që ndaj të akuzuarve të mbahet gjykimi në mungesë pasi që “janë shterur të gjitha përpjekjet ligjore për t’i gjetur ata”.

Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000

civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Ndërsa numri i saktë i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës nuk dihet.

Sipas një raporti të Qendrës Amerikane për Kontrollimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, kjo shifër arrin deri në 20 mijë. Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008 dhe njihet nga mbi 100 vende të botës. Serbia nuk e njeh pavarësinë e saj dhe në Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë pjesë të territorit të vet.

## Spanca fton institucionet t’i forcojnë masat për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në bashkëpunim me Zyrën e UN Women në Kosovë, kanë mbajtur një tryezë pune, në të cilën kanë paraqitur rezultatet e auditimit të performancës “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”.

Qëllimi i kësaj tryeze, përveç shpalosjes së rezultateve të auditimit, ishte edhe t’i mbledhë së bashku edhe palët përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve. Me këtë rast, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, Avokati i Popullit, Naim Qelaj dhe udhëheqësa e UN Women në Kosovë, Vlora Nushi, përveç që kanë vlerësuar lart rezultatet e auditimit, kanë shprehur domosdoshmërinë e marrjes së masave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Spanca ka theksuar se dhuna në familje nuk njihet kufij, prandaj duhet krijuar dhe fuqizuar mekanizmat që parandalojnë dhe luftojnë këtë dukuri.

Si rezultat i këtij auditimi vërehet se institucionet përgjegjëse kanë ndër marrë një sërë veprimesh për

trajtimin e rasteve të dhunës në familje, megjithatë nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave. “Lufta kundër dhunës në familje nuk është thjesht një detyrë, por përgjegjësi morale. Bashkë mund të bëjmë më shumë duke krijuar një shoqëri ku dëgjohen zërat e të pambrojturve, ta përmirësojmë situatën për viktimat e dhunës në familje dhe të krijojmë një shoqëri më të sigurt dhe të drejtë për të gjithë”, ka thënë Spanca.

Ndërsa ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka shprehur mirënjohjen dhe respektin për punën audituese, duke theksuar se mirëpret raportin si të parin e këtij lloji në vend nga Zyra Kombëtare e Auditorit. Më tutje, ministria Haxhiu ka përmendur disa nga nismat dhe rezultatet e arritura nga Ministria e Drejtësisë, siç janë: hartimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna Ndaj Grave 2022-2026, hartimi i Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunimeve Seksuale; miratimi i kurrikulës mbi zhvillimin e programeve për kryesit e dhunës në familje dhe dhunës



ndaj grave, miratimi i Projektligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, miratimi i Projektligjit për Ndihmë Juridike Falas, plotësim/ndryshimi i Kodit Penal dhe miratimi i ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale, fuqizimi institucional e financiar i strehimoreve, në mbi 100 për qind më shumë se në vitet e kaluara dhe një sërë nismash të tjera të cilat gradualisht po ngriten në kuadër të standardeve të asaj që njihet si Konventa e Stambollit.

Në anën tjetër, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se, edhe përkundër përpjekjeve

shumëvjeçare të institucioneve, përkundër angazhimit dhe masave të ndërmarra, rastet e dhunës në familje janë shtuar. Ai ka theksuar se kjo mund të merret edhe si rezultat i vetëdijesimit dhe raportimit të rasteve, por kjo nuk e eviton faktin se dhuna në familje është shumë e pranishme në shoqërinë tonë. Kjo shton nevojën që institucionet, në përgjithësi shoqëria, të reagojë dhe t’i marrë të gjitha masat për ta luftuar këtë dukuri.

Kurse shefja e Zyrës së UN Women në Kosovë, Vlora Nushi, ka thënë se buxheti i përgjegjshëm gjinor

dhe rritja e efikasitetit institucional në trajtimin e rasteve të dhunës në familje janë dy anë të së njëjtës medalje. “Ne si UN Women e shohim si vendimtare përfshirjen dhe shtimin e buxhetimit gjinor në çdo aspekt, meqë vetëm në këtë mënyrë investimi në përmirësimin e jetës së grave është më i qëndrueshëm. Jemi të lumtur që kemi pasur mundësinë të ofrojmë asistencë teknike në këtë raport brenda kornizës së programit ‘Financimi transformativ për barazi gjinore drejt një qeverisjeje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor’, i cili zbatohet në nivel rajonal dhe financohet nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida)”, ka thënë Nushi.

Në përmblyllje të tryezës, zëvendësauditatori i përgjithshëm, Beza Halilaj, ka theksuar se “është detyrim kushtetues i shtetit që ta sigurojë të drejtën e qytetarëve për jetë, prandaj puna e përbashkët e drejtuesve institucionalë sjell më shumë rezultate në luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje”.

## Lirie Hoti emërohet drejtoreshë e Bujqësisë në komunën e Podujevës

PODUJEVË, 14 SHTATOR - Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, ka emëruar Lirie Hotin drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Lirie Hoti ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik në nivelin master dhe studimet në Departamentin Gjuhë dhe Letërsi Angleze në nivelin bachelor. Gjithashtu, ka përfunduar

edhe provimin e Jurisprudencës. Hoti ka punuar sekretare e shkollës në “The British School of Kosova” dhe asistente në Kolegjin “AAB”.

Kryetari Bulliqi e ka uruar

drejtoreshën Hoti për detyrën e re, duke i dëshiruar suksese dhe mbarësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë. Po ashtu, i ka siguruar mbështetje dhe bashkëpunim të plotë.



## Arifi dhe Escobari bisedojnë për të drejtat e shqiptarëve në Luginë dhe pasivizimin e adresave

WASHINGTON, 14 SHTATOR - Kryetari i Preshevës, Shqiprim Arifi, është takuar me të dërguarin e posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Arifi ka thënë se Escobarit ia ka shprehur shqetësimin “mbi privimin e të drejtave bazë të shqiptarëve në Luginë të Preshevës si dhe ndalimin e procesit të pasivizimit të adresave.” “Në takim me zëvendësndihmësin e sekretarit të Shtetit dhe i dërguar i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, z. Gabriel Escobar, mundësi diskutimi mbi

zhvillimet aktuale politike, veçanërisht për çështjen e Luginës së Preshevës. Adresova shqetësimin e madh mbi privimin e të drejtave bazë të shqiptarëve në Luginë të Preshevës si dhe kërkova ndalimin e procesit të pasivizimit të adresave, proces i cili shkel drejtpërdrejt të drejtat elementare njerëzore. Lidhja e ngushtë politike me ShBA-në është e pandryshueshme dhe garanci për forcimin e Republikës së Kosovës. Sa më e fortë Kosova, po aq Luginë e Preshevës!”, ka njoftuar Arifi.



## Leposaviqi dhe Zubin Potoku votojnë për anëtarësimin në Asociacionin e Komunave të Kosovës

LEPOSAVIQ/ ZUBIN POTOK, 14 SHTATOR - Kuvendi Komunal i Leposaviqit dhe ai i Zubin Potokut kanë votuar për anëtarësimin e këtyre dy komunave në Asociacionin e Komunave të Kosovës. Lajmin e ka dhënë Lëvizja Vetëvendosje. Lista Serbe e ka kundërshtuar këtë vendim, duke thënë se “ai nuk është në përputhje me kërkesat e serbëve lokalë” dhe, se i tillë, “do të vazhdojë ta përshkallëzojë situatën në veri të Kosovës”. Në fund të muajit të kaluar Asociacionit iu bashkua edhe komuna e Mitrovicës së Veriut. Pas zgjedhjes së kryetarëve të rinj shqiptarë në komunat në veri të Kosovës në prill - Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan - në zgjedhjet e bojkotuar nga qytetarët serbë, Mitrovica e Veriut dhe Leposaviqi kishin kërkuar nga institucionet e Kosovës që ndërtesat publike të këtyre komunave të kyçen në sistemin energjetik të Kosovës dhe



të paguajnë për energjinë elektrike të komunave që udhëheqin. Mitrovica e Veriut, së bashku me tri komunat e tjera në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan, që nga përfundimi i luftës

më 1999, nuk kanë paguar për rrymën e shpenzuar. Faturat e energjisë së shpenzuar në veri fillimisht janë paguar nga qytetarët e pjesëve të tjera të Kosovës dhe që nga viti 2017 nga Qeveria e Kosovës. Megjithatë, në

këto dy komuna dhe në dy të tjerat në veri të Kosovës pritet të mbahen zgjedhje të parakohshme, të kërkuara nga komuniteti ndërkombëtar për shtensionim të situatës në veri, që është përkeqësuar që nga fundi i majit. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në zgjedhjet të parakohshme për kryetar të komunës mund të shkohet në rast se kryetari aktual jep dorëheqje; në rast se qytetarët kërkojnë shkarkimin e kryetarit të komunës përmes një peticioni të nënshkruar nga 20 për qind e votuesve të komunës përkatëse; si dhe në rast se kryetari i komunës

nuk paraqitet në vendin e punës më shumë se një muaj pa arsye. Asociacioni i Komunave të Kosovës funksionon në Kosovë si organizatë jopfitabile e themeluar për t'i përfaqësuar dhe për t'u shërbyer interesave të anëtarëve të saj, gjegjësisht komunave të Kosovës. Pjesë e këtij asociacioni janë 34 komuna të Kosovës. Kuvendi ka 126 anëtarë dhe përbëhet nga të gjithë kryetarët e komunave dhe nga një këshilltar i zgjedhur për secilin nga dhjetë këshilltarët komunalë dhe përfaqësues nga komunitetet joshumicë në kuvendet e komunave. Misioni i këtij asociacioni është të krijojë qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike përmes përpjekjeve të përbashkëta me komunat dhe përmes tyre të arrihet një performancë e kualitetit të lartë në shërbimin e nevojave për anëtarët e saj.

## Minxhozi lirohet nga detyra, Malaj emërohet ambasador i ri i Shqipërisë në Kosovë

TIRANË, 14 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, e ka emëruar ambasador në Kosovë Petrit Malajn. Ai ka liruar nga detyra ambasadorin e deritanishëm Qemajl Minxhozi. Përveç në Kosovë, Begaj ka emëruar edhe shtatë ambasadorë të rinj. Begaj ka liruar Saimir Balën nga detyra e ambasadorit në Kuvajt dhe në Irak. Në vend të Balës, Begaj ka emëruar Ilir Hysën. Nga detyra e ambasadorit të Shqipërisë në Çeki është liruar

edhe Ilirian Kuka. Në vend të tij është emëruar Ilir Tepelena, i cili ka qenë ambasador në Rumani. Ambasadore e re në Rumani është emëruar Enkelelda Mërkuri, e cila ka shërbyer ambasadore në Sllovaki. Presidenti Begaj ka liruar nga detyra edhe ambasadorin e Shqipërisë në Slloveni, Pëllumb Qazimi. Në vend të tij ka emëruar Oljan Kanushin. Po ashtu, Begaj ka liruar nga detyra e ambasadores së Shqipërisë në Danimarkë, Elida Petoshati. Në



## Dogana konfiskon pjesë të makinave në vlerë prej 10 mijë eurove

FUSHË-KOSOVË, 14 SHTATOR - Dogana e Kosovës ka sekuestruar mall në vlerë prej 10 mijë eurove që shiteshin në mënyrë të padeklaruar. Sipas doganës, ky aksion është vazhdim i aksionit të zhvilluar më 11 shtator, në të cilin është parandaluar kontrabandimi i

disa pjesëve të veturave. “Si rezultat i hetimeve është arritur të lokalizohet objekti ku këto pjesë të makinave tregtoheshin në mënyrë të padeklaruar. Pas identifikimit të lokacionit është bërë edhe bastisja e këtij lokacioni në Fushë-Kosovë. Në objekt janë

gjetur pjesë rezervë, ulëse dhe pjesë të tjera të enterierit të veturave. Personat përgjegjës nuk ka pasur dokumentacion përkatës dhe dyshohet se është i kontrabanduar në territorin e Republikës së Kosovës. Vlera e mallit të konfiskuar llogaritet të jetë

rreth 10 000 euro. Gjithashtu, lidhur me këtë rast, është njoftuar edhe Prokuroria Themelore në Prishtinë. Ky sukses i Doganës së Kosovës dëshmon përkushtimin në luftën kundër kontrabandës dhe aktivitete ilegale”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.



## “Liberalizimi i vizave do të ketë efekt në ekonominë e Kosovës”

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Udhëtimi pa viza në Bashkimin Evropian do të ketë efekt në ekonominë e Kosovës. Ekspertët e ekonomisë kanë paralajmëruar se Kosova do të ballafaqohet me mungesë të punëtorëve.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka thënë se tashmë Kosovën është duke e përcjell kjo sfidë e ikjes së të rinjve jashtë vendit. “Liberalizimi i vizave padyshim që do ta ketë impaktin e vet në tregun e punës, por nuk pres që të rinjtë të largohen. Kjo do t’u hapë mundësi të rinjve e të rejave që të shkojnë në vende të ndryshme të BE-së, më pas ata do të aplikojnë për viza pune e kjo do të ndikojë që të vërehet mungesa e fuqisë punëtore në Kosovë. Kjo është një sfidë që është



duke na përcjell tani, sidomos dy vitet e fundit.

Qeveria urgjentisht duhet ta përgatisë një strategji që ta

parandalojë ikjen e të rinjve jashtë dhe ta shohë mundësinë e kthimit të atyre”, ka thënë ai për “Radio Kosovën”.

Ndërsa kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shajini, ka thënë se me liberalizimin e vizave qytetarët e Kosovës më nuk do t’i paguajnë 20 milionë euro në vit në ambasadë për marrje të vizave. Ai ka thënë se liberalizimi do ta rrisë interesimin e qytetarëve për të dalë në Evropë e që, sipas AKB-së, në vitin e parë vendin mund ta lëshojnë 150 mijë qytetarë. “Efekt pozitiv është se kosovarët më nuk do t’ua paguajnë 20 milionë euro në vit ambasadave për të marrë viza dhe për të pritur muaj të tërë. Qytetarët do të kenë mundësi të lëvizin lirshëm. Për sa i përket tregut të

punës, do të rrisë interesimin e qytetarëve për të dalë në Evropë dhe, sipas parashikimeve tona, rreth 150 mijë qytetarë vitin e parë do ta lëshojnë Kosovën për të tentuar të gjejnë ndonjë mundësi të punësimit dhe jetesë më të mirë”, ka thënë Shajini.

Ai ka theksuar se tashmë Gjermania ka miratuar një ligj që u mundëson të gjithë qytetarëve të Ballkanit punësim dhe qëndrim në këtë shtet. Sipas tij, kjo do ta varfërojë tregun e punës duke marrë fuqinë punëtore. “Kjo do të marrë një fuqi të madhe të punëtorëve në gjithë Ballkanin. Do ta varfërojë tregun e punës në Kosovë, konsumin e përgjithshëm, më shumë edhe taksat, por do të kemi edhe më pak votues”, ka thënë Shajini.

## BQE-ja, kritika ndaj taksës italiane mbi fitimet e “papritura” të bankave

FRANKFURT, 14 SHTATOR - Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka kritikuar taksën e propozuar nga Qeveria e Italisë mbi fitimet e “papritura” të bankave, duke thënë se nuk merrte parasysh perspektivat afatgjatë të huadhënësve dhe mund t’i bënte disa prej tyre të preکشme ndaj një rënijeje ekonomike.

Muajin e kaluar Roma ua ka dhënë një goditje befasuese huadhënësve të vendit, duke vendosur një taksë prej 40-përqindësh mbi fitimet e tyre që vijnë nga normat më të larta të interesit pasi i kritikoi ata për mosrritjen e kthimit nga depozitat.

Aksionet e bankave ranë pas daljes së këtij njoftimi, ndërsa u rikthyen pasi Ministria e Ekonomisë sqaroi se taksa e

re do të arrinte jo më shumë se 0.1 për qind të totalit të aktiveve të huadhënësve.

“Shuma e tatimit të jashtëzakonshëm mund të mos jetë në përpjesëtim me përfitimin afatgjatë të një institucioni krediti dhe kapacitetin e tij të gjenerimit të kapitalit. Si rezultat i aplikimit të përgjithshëm të taksës së jashtëzakonshme, institucionet e kreditit që kanë pozicione më të ulëta aftësi pagese ose janë më të fokusuara në aktivitetin kreditues (siç janë bankat e vogla) ose kanë projeksione sfiduese të kapitalit, mund të bëhen më pak të afta për t’i absorbuar rreziqet e mundshme negative të një rënijeje ekonomike”, është shprehur BQE-ja.

Ligjvënësit italianë pritet të



paraqesin propozime këtë javë për ta zbutur ndikimin e taksës, duke përfshirë elementin që bankat të lejohen të zbresin pjesërisht atë që duhet të paguajnë nga

fatura e tyre e përgjithshme e taksave të korporatave.

Ndryshime të tjera ka të ngjarë t’i përjashtojnë bankat më të vogla nga pagesa e taksës ose ta rishikojnë

kufirin duke e llogaritur në bazë të aktiveve të ponderuara me rrezik në vend të aktiveve totale.

BQE -ja ka theksuar se nuk ishte plotësisht e qartë se si do të bëhej llogaritja e “aseteve totale” dhe ka rritur parashikimin që bankat mund të regjistronin humbje ose fitime më të ulëta kur paguanin taksën në mesin e vitit 2024, siç parashikohet nga skema e qeverisë.

Institucioni më i lartë financiar evropian ka vënë në dukje se efekti pozitiv mbi bankat nga normat më të larta të interesit mund të kompensohet nga vëllime më të ulëta të huadhënies, një kosto më e lartë financimi dhe humbje nga borxhet e këqija nëse ekonomia përkeqësohet.

## Buxheti i Prishtinës për vitin 2024 do të jetë mbi 123 milionë euro

Prishtinë, 14 shtator - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se buxheti i kryeqytetit, i cili është votuar të enjten për vitin 2024, është 20 milionë

euro më i lartë se i vitit të kaluar. Sipas Ramës, buxheti për vitin 2024 do të jetë 123 milionë e 699 mijë e 998 euro. “Buxheti i kryeqytetit, i cili sapo u votua në Kuvend, për

vitin 2024 do të jetë 123 milionë e 699 mijë e 998 euro. Pra, rreth 20 milionë më i lartë se në vitin e kaluar. Buxheti i vitit 2024 është buxhet i projekteve të mëdha kapitale, të cilat kanë

qenë premtime qysh prej ditës së parë të punës sime në kryeqytet. Pra, do të jetë një buxhet i transformimit të kryeqytetit”, ka shkruar Rama në “Facebook”.





# Dhjetë personalitetet që ndryshuan botën në shekullin XX



Cili është fjalimi i Martin Luther Kingut që ndërroi Amerikën? Kush ishte njeriu që ka mundur të heq Stalinin nga pushteti? A është vërtet Khomeini lideri i cili nisi Lëvizjen anti-perëndimore te shtetet islamike? Pse Marilyn Monroe gjendet në këtë listë? Kush ishte në të vërtetë Ernesto Che Guevara? Kush është mbreti i vetëm të cilin e ka pranuar dhe respektuar Amerika? Për çka do të mbahet në mend Mao Zedong? Pse Albert Einstein tmerrohej prej përparimin teknologjik? Cili ishte urdhëri i fundit i Adolf Hitlerit? Si ngadhënjeh Gandhi ndaj fuqisë më të madhe kolonialiste? Telegrafi sjell listën e dhjetë personaliteteve që ndryshuan botën në shekullin XX...

## NOBELIST DHE MARTIR: MARTIN LUTHER KING

King është shumë i njohur në Amerikë sesa në Evropë. Ky me siguri meriton të gjendet në këtë listë sepse veprimtaria e tij politike bëri që të ndryshojë historia në shtetin më të rëndësishëm të epokës sonë, në ShBA. Fjalimi i tij legjendar "I have a dream", i mbajtur në Uashington, në vitin 1963, para 250 mijë vetave, njihet thuaja përmendësh nga çdo qytetar amerikan.

King ishte prijtar i një lëvizjeje paqësore të llojit gandist, sepse kuptoi që kjo rezistencë mund të bëjë shumë më tepër për përmirësimin e të drejtave të afro-amerikanëve në Amerikë se sa çfarëdo rebelimi i dhunshëm. Përndryshe, King kishte studiuar teologjinë, së pari në Universitetin "Crozer" të Pensilvanisë e pastaj edhe në atë të Bostonit. Në Boston edhe doktoroi, në vitin 1955.

Pas doktorimit, vendoset në një kishë në Alabama. Në fillim, King mendonte që përmes rrugëve legale, mund të ndikojë në ndryshimin e pozicionit të zezakëve, por së shpejti ky kuptoi që në rrethanat e atëhershme, nuk mund të bëhet shumë në këtë mënyrë. Prandaj, vendosi të iniciojë një lëvizje të rezistencës së padhunshme. Kësaj lëvizjeje, me kalimin e kohës, nisi t'i bashkëngjiten edhe qytetarë tjerë të Amerikës, të racave të ndryshme.

Pas fjalimit të tij njëmend të madhërisht në Uashington, King nisi të çmohej shumë kudo në Amerikë. "TIME" e pat shpallur Kingun "njeriun e vitit", ndërsa vitin tjetër, më 1964, ai mori çmimin Nobel për Paqe. Megjithatë, Kingu kishte telashe të mëdha dhe atë jo vetëm me pushtetin. Edhe në mesin e afro-amerikanëve kishte të

pakënaqur me mungesën e rezultateve konkrete të lëvizjes së tij. Këta shkonin te Malcolm X dhe "Panterët e Zi", të tij, që predikonin rezistencë me të gjitha mjetet e mundshme. Pastaj, midis të bardhëve, King gjithnjë e më shumë shihej si burim i problemit dhe si një i deleguar i djallit. Po ashtu, edhe tek përkrahësit e tij, gjithnjë e më shumë shtoheshin dyshimet për sukses dhe madje haptazi predikohej ateizmi.

Së fundit, King nisi të flasë edhe kundër inkuadrimit të Amerikës në Luftën e Vietnamit, gjë që po ashtu shihej si problematike në atë kohë.

Martin Luther King u vra me 4 prill të vitit 1968, në Memphis. Për vrasjen e tij u dënua James Earl Ray, i cili më vonë vdiq në burg. Pakkush ka besuar që Ray ka qenë i vetmuar në këtë vrasje, ashtu si në rastin e vrasjes së Kennedyt, kur thuaja askush nuk besonte që Lee Harvey Oswald ishte vrasësi i vetëm i tij.

Në vitin 1999, Gjykata më Memfis e ka shpallur të pafajshëm James Earl Rayin. Vrasësit e njëmendtë të Kingut nuk janë gjetur sot e kësaj dite. Por, dyshimet shkojnë tek pushteti i atëhershëm amerikan dhe shërbimet sekrete të cilat ishin të interesuara të heqin qafe Kingun.

## SUNDUESI I GJYSMËS SË EVROPËS: STALINI

"Manifesti i partisë komuniste" i Karl Marksit (Karl Marx), është një nga librat që ndikuan më së shumti në historinë e njerëzimit në shekujt XIX dhe XX. Është një libër i hollë të cilin me siguri nuk e njohin gjeneratat e reja të kosovarëve, edhe pse Kosova, ashtu si edhe gjysma e Evropës, ka jetuar nën komunizëm për gati gjysmë shekulli. Në fund të këtij regjimi, është përpiluar "Libri i zi i komunizmit", i cili është diku njëzet herë a më shumë më i trashë se "Manifesti", në të cilin janë përmendur krimet kryesore të bëra në emër të komunizmit në Evropë dhe gjetiu.

Natyrisht, këtu ka pak rëndësi që Marksia dhe miku i tij Engelsi (Friedrich Engels), kur shkruan "Manifestin" mendonin që komunizmi duhet të instalohet në shtetet më të pasura dhe më të industrializuara të Perëndimit, e jo në Rusi dhe në vendet më të varfra të Evropës. Marksia në disa raste me përcmim kishte shkruar dhe folur për Rusinë, por Rusia u bë atdheu i realizimit të ideve të tij. Revolucioni komunisto-bolshevik do të ndodhë në tetor të vitit 1917 në Petrogradin e

atëhershëm (i cili më vonë do të ndërrojë emrin në Leningrad e sërish do të kthehet në Petrograd). Këtij revolucionit do t'i prinë Vladimir Iliq Lenini, një ithtarë i madh i veprës së Karl Marksit. Pas vdekjes së Leninit, në vitin 1924 do të nisë lufta politike për trashëgiminë e tij midis Lav Trockit, Komandantit të Parë të Armatës së Kuqe dhe Josif Visarionoviq Stalinit, i cili kishte studiuar teologjinë për tu bërë pastaj revolucionar. Trocki do të humbë këtë luftë dhe do të dëbohet nga Bashkimi Sovjetik. Në vitin 1940, një agjent i NKVD-së (Shërbimit Sekret Sovjetik), do ta vrasë Trockin në Meksiko.

Stalini do të sundojë me "dorë të hekurt" me Bashkimin Sovjetik, por edhe organizatën gjithëkomuniste të quajtur Komintern. Do të krijojë një mori kampesh përqendrimi, në të cilat do t'i dërgojë miliona armiq të tij. Thuhet që në periudhën e sundimit të tij kanë vdekur në Bashkimin Sovjetik mbi 20 milionë veta.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Stalini dhe Bashkimi Sovjetik do të sundojnë me Gjysmën e Evropës: Prej Baltikut deri në Adriatik, si është thënë atëherë. Stalini do të vdesë në vitin 1953. Tri vjet më vonë, Nikita Hrushovi, i cili do të dalë si




trashëgimtar i tij, do të nisë të kritikojë Stalinin për terrorin e tij. Por, Stalini, sot e kësaj dite vazhdon të jetë politikan i çmuar në Rusi.

Roli i tij ka qenë shumë i rëndësishëm edhe në zhvillimet në këtë pjesë të Evropës. Liderët serbë të asaj kohe kanë thënë që Stalini ka përkrahur idetë që Shqipëria të absorbohet nga Jugosllavia e atëhershme, ndërsa Enver Hoxha, diktatori shqiptar, do të shkruajë të kundërtën: Që Stalini do ta shpëtojë Shqipërinë nga Jugosllavia.

### GIJTHÇKA NISI NË IRAN: KHOMEINI

Në vitet e shtatëdhjeta të Shekullit XX, Irani ka qenë njëri prej aleatëve kryesorë të Amerikës. Nën udhëheqjen e Shah Reza Pahlavit, Irani ishte një shtet sekular, me lidhje të forta me Perëndimin, çfarë ishte dhe mbeti sot e kësaj dite Turqia. Gratë atëbotë kishin të drejtë vote, urbanizimi dhe industrializimi i Iranit kishte marrë hov të madh, Irani ishte shtet që zhvillohej mjaft shpejtë. Megjithatë, tej kësaj përshtypjeje të parë, gjendja në Iran ishte larg asaj të dëshiruarës. Vorfëria e popullatës ishte shumë e madhe, korrupsioni në pushtet i pakufishëm, njëkohësisht, luksi i familjes Pahlavi dhe përkrahësve të tyre tepër provokues. Demonstratat e njëpasnjëshme dhe reagimet e vrazhda të forcave të sigurimit bënë që t'i vijë fundi regjimit të Pahlavit, përkundër përpjekjeve të ShBA-së që disi të ruajë këtë aleat në Azi, i cili aq shumë i nevojitej viteve të shtatëdhjeta.

Pas Pahlavit, në Teheran kthehet Ajatollah Homeini (Sayyid Ruhollah Mūsavi Khomeini), i cili për vite kishte qëndruar në Paris, i dëbuar nga ky regjim. Iranianët e pritën Homeinin si shpëtimtar. Ky nuk vonoi dhe shpalli që në Iran më nuk kanë çfarë të kërkojnë amerikanët. Për më tepër, Homeini cilësoi Amerikën si "djallin e madh", i cili kundërshtonte Islamizmin. Studentët ekstremistë iraninë, në vijim të porosive të Homeinit, hynë në Ambasadën e ShBA-së në Teheran dhe kidnapuan 52 diplomatë dhe teknikë të kësaj ambassade. Administrata e presidentit Jimmy Carter u mundua t'i lirojë ata në të gjitha mënyrat: Prej sanksioneve ekonomike deri te përpjekja e pasuksesshme e forcave elite të cilat dështuan, duke lënë prapa tetë ushtarë amerikanë të vrarë në shkretëtirat e Iranit. Pengjet u



liruan tek në vitin 1981. Një vit më parë, Irani hyri në një luftë tetëvjeçare me fqinjin Irakun, e cila nuk solli fitues por vetëm qindra mijëra vetë të vrarë.

Ajaltollah Homeini vdes në vitin 1989, duke lënë prapa vetes një shtet fetar. Shembulli i Homeinit dhe Iranit u ndoq nga shumë lëvizje islamiste. Llogaritet që ndikimi i Homeinit ishte njëmend vendimtar në forcimin e lëvizjeve politike dhe fetare në botën islamike, posaçërisht në Afganistanin fqij, i cili në vitet e tetëdhjeta luftonte për çlirim nga forcat okupatore të Bashkimit Sovjetik.

Sot Irani nuk është më një shtet rigjid fetar, por megjithatë, ai vazhdon të cilësohet nga Uashingtoni si pjesë përbërëse e "Boshtit të së Keqes", tok me Irakun dhe Korenë e Veriut.

### FEMRA MË E NJOHUR E SHEKULLIT XX: MARILYN MONROE

Mund të thoni që kalimi prej një ideologu dhe fetari, çfarë është Homeini, në një aktore dhe bukuroshe çfarë ishte Marilyn Monroe, është një lloj provokimi i qëllimshëm. Por, Marilyn Monroe e ka vendin në këtë listë sepse ajo ka ndikuar shumë në jetën, filmin dhe kulturën e Amerikës së viteve të pesëdhjeta e të gjashtëdhjeta. Rrëfimi për Norma Jeanin, siç është emri origjinal i Marilyn Monroes, është pak a shumë i njohur për të gjithë juve. Norma Jean u martua herët dhe me siguri jeta e saj do të ishte e mërziatshme dhe aspak interesante për ne, sikur një fotograf, i quajtur David Conover, nuk e zbuloi në fabrikën ku kjo punonte.

Nuk vonoi dhe Norma Jean ndërron emrin në Marilyn Monroe, nënshkruan kontratën me "20th Century Fox", bëhet biondinë (në "origjinal" ishte abrashe) dhe xhiron filmin e parë "Burrat preferojnë biondinat", për të cilin merr honorarin në vlerë prej 125 dollarë. Marilyn Monroe, në vijim të popullaritetit martohet me Joe DiMaggian, legjendën e bejsbollit amerikan. Martesa do të zgjasë vetëm nëntë muaj, sepse dallimet në karaktere ishin shumë të mëdha. Edhe martesa tjetër e Monroes, me shkrimtarin e madh amerikan Arthur Miller, do të përcillet me një interesim shumë të madh të opinionit amerikan. Kësaj here, martesa zgjati më shumë, gati tre vjet, por Marilyn u shkurorëzua sërish. Pastaj, ajo u bë e njohur për aferat e saja të



dashurisë me presidentin John F. Kennedy dhe vëllaun e tij Robert. Të gjithë mbajnë në mend se si Marilyn i ka kënduar "Happy Birthday Mr. President", John Kennedyt, për ditëlindje. Marilyn Monroe do të gjendet e vdekur, në apartamentin e saj, në vitin 1962, kur kishte vetëm 36 vjeçe. Versioni zyrtar i vdekjes së saj është që ajo bëri vetëvrasje, duke përdorur barëra për qetësim, pa të cilat nuk mund të flinte. Megjithatë, sot e kësaj dite, vdekja e saj cilësohet si enigmatike dhe e pasqaruar deri në fund. Shumëkush është i prirë të lidhë vdekjen e saj me lidhjet që kishte me vëllezërit Kennedy.

Sidoqoftë, popullariteti i saj nuk pësoi fare rënie pas vdekjes. Përkundrazi. Filmat e saj janë përherë shumë të popullarizuar, ndërsa CD-të me muzikën e filmave, ku edhe kjo këndon, janë gjithmonë të mirëpritur nga publiku.

Në vitin 1999, kur Magazina "Playboy", më e njohura në botë për "shijen mashkullore" bëri përzgjedhjen e njëqind femrave më joshëse të shekullit XX, Marilyn Monroe pothuaj nuk kishte konkurrencë të denjë. Ajo pra u shpall si Njëshi i botës femërore në qindvjeçarin e kaluar.

Por, pakkush mund të kontestojë që ajo vdiq si femra më e famshme dhe njëkohësisht më fatkeqe në Amerikë.

### MJEK DHE REVOLUCIONAR: CHE

Çe Gevara (Ernesto Che Guevara), me mjekër dhe flokë të gjata të denja për një rok-yll, me beretën dhe yllin në të, me një shikim të veçantë, është një nga fotografitë më të njohura të shekullit XX. Këtë askush nuk e mohon. Por nuk janë të shumtë ata që dinë sot detaje të biografisë së këtij revolucionari i cili tok me Fidel Castron bëri që Kuba të shndërrohet në shtet komunist. Filmi "Evita" i Alan Parkerit, me Madonnën në rolin e Eva Peronit, gruas së Juan Peronit, kryetarit të Argentinës dhe Antonio Banderasin në rolin e Çe Gevarës, bëri që publiku të njihet pak më shumë për Çe Gevarën.

Çe Gevara u lind në Argentinë. Nën ndikimin e madh të së ëmës, Ernesto nisi të interesohet shumë për letërsi. Ernesto ishte shumë inteligjent dhe prej letërsisë së shpejti kaloi në vepra filozofike dhe politike. Ndër autorët e tij më të preferuar ishin Karl Marxin dhe Sigmund



Freudi. Ernesto ishte i dhënë shumë edhe pas sporteve të ndryshme, edhe pse ishte i sëmurë prej astmës.

Kriza e madhe ekonomike në Argentinë, në kohën e Juan Peronit, bëri që Gevara të humbë në tërësi besimin në një rend demokratik parlamentar. Për më tepër, ai mendonte që ShBA-ja është armiku kryesor i Argentinës dhe klasës punëtore. Por, do të kalojë një kohë derisa ky të mos përcaktohet për metoda revolucionare. Në Universitetin e Buenos-Ajresit, do të studiojë mjekësinë dhe gazetarinë. Udhëtoi shumë nëpër Amerikën Latine. Në Mexico City do të njihet me vëllezërit Castro – Fidelin dhe Raulin. Poçësorisht u afrua me Fidelin i cili e thirri për t'iu bashkangjitur në luftën për krijimin e pushtetit komunist në Kubë. Ernesto Gevara mori nofkën Çe dhe u bë njëri prej komandantëve më të njohur të ushtrisë revolucionare kubaneze.


Pas vendosjes së regjimit të ri në Kubë, ishte personaliteti i dytë për nga rëndësia në Havanë, menjëherë pas Castros. Në vitin 1965, do të botojë librin "Socializmi dhe Njeriu", në të cilin shprehte idetë dhe qëndrimet e tij, të afërta me Anarkizmin. Largimi i tij nga marksizmi dhe këmbëngulësia e tij që ishte pasojë e karakterit të tij, bëri që ky të largohet nga Kuba.

Çe do të udhëtojë në Afrikë për të bërë revolucion atje, pastaj do të kthehet në Bolivi, prapë me synime për të ndryshuar botën. Nuk do të vonojë dhe ushtria boliviane do ta zë dhe ekzekutojë. Edhe fotografitë e Çe Gevarës të vrarë, do të qarkullojnë pastaj në tërë botën. Prej atëherë, Çe Gevara u shndërrua në njërin ndër mitet bashkëkohore, që personfikon një kryengritës i cili s'pajtohet me botën. U harruan përcaktimet e tij komuniste dhe mbet gjallë vetëm karakteri i tij rebelues.

### VDIQ NË KULMINACIONIN E KARRIERËS: ELVIS PRESLEY

Kur në vitin 1977, nën ndikimin e drogave, vdiq Presley, Amerika u gjet në shok. I vetmi mbret që mbretëroi në shtetin më të fuqishëm në Botë, në ShBA, ishte Elvis Presley, i cili u cilësua, me të drejtë, si "Mbret i Rokënrolit".

Elvis Aaron Presley u lind në Tupelo, në Mississipy, në vitin



1935. Vëllai i tij binjak vdiq menjëherë pas lindjes dhe ky u rit si fëmija i vetëm në familje. Për këtë shkak, e ëma e ka dashur shumë dhe është kujdesur shumë për të. Kjo përkujdesje ka lënë gjurmë të përhershme të Presley i cili gjithmonë ka mbetur i varur prej së ëmës.

Në vitin 1948, familja e tij shpërngulet në Memfis, vendin prej ku nis karriera e jashtëzakonshme e Elvis Presleyt.

Ndikimet e para muzikore në Presleyin lidhen me country muzikën, por ky ishte veçanërisht i fascinuar me gospelin (muzikë shpirtërore religjioze e zezakëve të Amerikës). Në vitin 1954, Elvis nënshkruan kontratën me Shtëpinë e njohur diskografike "Sun", pastaj kalon në RCA. Prej vitit 1956, Elvis nis të pushtojë top-listat në Amerikë dhe në botë. Elvis kishte një paraqitje të re skenike, sillej dhe këndonte si një zezak dhe kjo ishte befasia më e madhe në Amerikë e asaj kohe. Për këtë shkak, zatën, Presley ishte ndër rok-yjet e para, i cili dëgjohej me ëndje prej të gjithëve, pa marrë parasysh statusin social apo prejardhjen raciale. Presley i bashkoi të gjithë në adhurimin e tij të paparë në historinë e muzikës.

Pas suksesit në muzikë, Presley do të kalojë në industrinë e filmit, ku po ashtu ishte mjaft i suksesshëm. Në karrierën e tij ka xhiruar 33 filma, western, filma muzikor (nuk besojmë që së paku një herë nuk e keni parë filmin e tij "Viva Las Vegas" me En Margareth, aktoren e bukur e cila u bë edhe dashnore e tij) dhe publiku me ëndje përcjellte sukseset e tij filmike.

Elvis Presley ka shitur mbi një miliardë albuma, është nominuar 14 herë për Grammy, shpërbllimin më të rëndësishëm muzikor, të cilin e ka fituar tre herë.

Presley ka shërbyer edhe në ushtrinë amerikane. Do të pritët edhe në Shtëpinë e Bardhë nga Presidenti Richard Nixon, të cilit i kishte ofruar të bëhet agent i FBI-së.

Në vitet e shtatëdhjeta, do të trashet shumë dhe gjithnjë e më tepër do të përdorë droga të ndryshme. Do të vdesë i ri, si 42-vjeçar, më 16 gusht 1977 në pronën e tij, në Graceland, në Memphis. Aty edhe do të varroset. Prej atëherë, varrin e tij e kanë vizituar miliona adhurues të tij. Albumat e tij ribotohen sot e kësaj dite. Popullariteti i tij vazhdon të jetë shumë i lartë. Presley dhe "The Beatles" janë



autorët e hiteve më të njohura në historinë e rok-muzikës.

## KINEZI MË I RËNDËSISHËM I SHEKULLIT: MAO ZEDONG

Në vitin 1893, kur u lind Mao Zedong, Kina ishte në gjendje rrëmuje dhe asaj i kanosej edhe shkatërrimi i plotë si shtet. Dinastia Qin e cila sundonte me Kinën, nuk arrinte të përmirësojë gjendjen e rëndë ekonomike dhe populli gjithnjë e më shumë ishte i pakënaqur. Resurset e mëdha të Kinës i shfrytëzonin fuqitë e mëdha perëndimore. Mao Zedong do të hetojë herët këto probleme dhe do të zotohet që do të mundohet të ndryshojë situatën në Kinë. Natyrisht, si edhe në shumë raste të tjera të ngjashme, shumëkush injoroi synimet e Zedongut dhe mendoi që ky nuk mund të bëjë ndryshimet e premtuara. Por, dihet çfarë ndodhi. Zedong do të theksojë që në fillim njerëzit nuk i duan ndryshimet, por më vonë, ata i përqafojnë ato.

Lëvizja e Zedongut ngadhjenu ndaj asaj të Çang-Kai-Shekut dhe në vitin 1949, Zedong do të shpallë krijimin e Republikës Popullore të Kinës. Reformat e mëdha që Zedong instaloi, bënë të mundur që Kina të bëhet njëra ndër shtetet më të fuqishme në Botë. Kinezët do të marrin pjesë edhe në Luftën e Koresë, në anën e aleatëve të tyre, komunistëve të Koresë Veriore. Në fillim, gati do të fitojnë, por më vonë, forcat amerikane dhe ato të aleatëve, do t'i zbrapsin kinezët. Çfarë mbahet në mend nga kjo luftë është gatishmëria e oficerëve kinezë për të flijuar mijëra ushtarë kinezë pa kurrfarë justifikimi.

Në vitet e gjashtëdhjeta, Zedong do të lansojë "Revolucionin Kulturor", me gjasë, më të egrin në historinë e komunizmit për sa iu përket përpjekjeve për "krijimin e njeriut të ri komunist". Fushata e demoncimeve, burgosjeve, arrestimeve do të përfshijë miliona veta.

"Revolucioni Kulturor" kinez do të ketë pasoja edhe në Shqipëri, e cila ato vite kishte krijuar raporte të posaçme me Kinën. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën do të nisen të prishen pas vizitës së Richard Nixonit, kryetar i atëhershëm amerikan, në Pekin. Thuhet që Enver Hoxha, lider i Shqipërisë komuniste, e kishte marrë si tradhti të interesave komunist



pritjen e Nixonit nga Zedong dhe prijës të tjerë të lartë kinez. Përfundimisht, Shqipëria do të priset me Kinën në vitin 1977. Vetë Mao Zedong do të vdesë në vitin 1976. Pushteti kinez do të ndërtojë maozolenë në të cilin do të vendosë trupin e balsamosur të Zedongut. Nuk do të vonojë dhe do të nisin kritikën e para ndaj regjimit të Zedongut dhe në veçanti, ndaj "Revolucionit Kulturor". Do të burgoset gruaja e Zedongut. Reformat që do të nisin në Kinë në vitet e tetëdhjeta, do të përjetojnë një ngecje pas demonstratave të njohura të vitit 1989, të cilat u shuan pas intervenimit të përgjashëm të Armatës kineze. Por, më vonë, reformat do të përtërihen dhe sot Kina është një shtet i fuqishëm.

## PERSONALITETI I SHEKULLIT XX SIPAS MAGAZINËS "TIME": EINSTEIN

Emri i Einsteinit lidhet me karrierën politike të Adolf Hitlerit. Po të mos vinte në pushtet Hitleri, Einstein dhe shumë shkencëtarë hebreikë që ishin qytetarë të Gjermanisë, kurrë nuk do ta braktisnin Gjermaninë. Ata u vendosën në SHBA dhe luajtën rolin kryesor në krijimin e bombës së parë atomike. Kjo bombë kishte për destinim të vetin primar Gjermaninë, por ajo kapitulloi. Kur Qeveria amerikane vendosi ta përdorë kundër Japonisë, shumë shkencëtarë hebreikë shkruan letër kryetarit Hary Truman, duke kundërshtuar këtë gjë. Por, tashti ishte bërë tepër vonë. Përndryshe, ekziston bindja që po të ishte gjallë presidenti Roosevelt (i cili vdiq në prill të vitit 1945), bomba atomike nuk do të përdorej as kundër Japonisë.

Albert Einstein u lind më 1879, në Ulm të Gjermanisë. Në vitin 1905, Einstein doktoroi në Universitetin e Cyrihut. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Einstein kthehet në Gjermani, ku bëhet profesor në Universitetin e Berlinit. Në vitin 1921 për herë të parë udhëton në Amerikë, ku mundohet të mbledhë mjete për universitetin e sapothemeluar hebreik në Jerusalem. Së shpejti Einstein merr edhe Çmimin Nobel, por jo për "Teorinë e relativitetit", siç mendohet zakonisht, por për punimet në efektin fotoelektrik, të cilat i kishte botuar qysh në vitin 1905.

Në vitetë njëzeta, Einstein bëhet



një shkencëtar shumë i njohur dhe i popullarizuar. Për këtë shkak ai udhëton shumë nëpër botë, duke popullarizuar shkencën dhe arritjet e tij personale. Por, duket që për shkak të udhëtimeve të shumta, ai sëmuhet. Në vitin 1928, ai vendos të shkojë në Princeton, në Amerikë, në universitetin e atjeshëm. Einstein nuk mendonte të rrijë përgjithmonë në Amerikë, por kur në vitin 1933 Hitleri merr pushtetin në Gjermani, Einstein vendos të mos kthehet më në atdhe. Për më shumë, në vitin 1940 ky edhe zyrtarisht merr shtetësinë amerikane, por, po ashtu, mban edhe shtetësinë zvicerane të cilën e kishte marrë më herët, gjatë qëndrimit të tij në Zvicër.

Në vitet e pesëdhjeta, gjendja e tij shëndetësore keqësohet shumë. Megjithatë, edhe pse i lodhur shumë, ky i drejtohet me letërën e famshme burrështetasve të botës, duke kërkuar prej tyre që të heqin dorë nga bomba atomike. Albert Einstein mbahet në mend si njëri ndër gjenitë e shekullit XX, i cili njëkohësisht ishte i vetëdijshëm për rreziqet që bart në vete zhvillimi i madh shkencor dhe teknologjik.

Magazina amerikane "TIME" ka shpallur në vitin 1999 Einsteinin personalitetin më të rëndësishëm botëror të shekullit XX.

## SIMBOLI I SË KEQES: ADOLF HITLERI

Natyrisht, këtu nuk ka nevojë të harxhohen shumë fjalë. Por, duhet përsëritur që kriteri për t'u gjetur këtu nuk kishte të bëjë vetëm me kontributin dhënë për të mirë qytetërimin. Përndryshe, ata që janë të prirë të bëjnë llogaritje të ndryshme, gjithsesi të vonuara për një dukuri, thonë që bota kurë nuk do të përjetonte tmerret më të mëdha në historinë e saj, sikur Hitleri të mos refuzohej nga Akademia e Artit në Vjenë. Ata thonë se Hitleri ka përjetuar shumë rëndë refuzimin e tij dhe se ky ishte ai momenti kyç që bëri që ky të kthehet një herë e përgjithmonë kah e keqja. Po të pranohej në akademi, Hitleri do të merrej me pikurë dhe nuk do të kthehej kah historia dhe politika.

Ndoshta edhe është ashtu, por kjo llogari është e kotë tashti. Dhjeta miliona vetë janë vrarë në luftërat të cilat i nisi Adolf Hitleri. Në vitin 1925, Hitleri do të botojë veprën e tij "Mein Kampf" ("Lufta ime"), në të cilën do të elaborojë pikëpamjet e tij politike. Ky libër deri në vitin 1939 (kur edhe



zyrtarisht nis Lufta e Dytë Botërore), do të përkthehet në 11 gjuhë dhe do të shitet në pesë milionë kopje.

Është interesant të theksohet që Hitleri kurrë nuk ka fituar në zgjedhje parlamentare dhe që në vitin 1933, në janar, pothuaj rastësisht merr detyrën e kryeministrit të Gjermanisë. Në të vërtetë, Hitleri duhej të ishte vetëm një zgjidhje kalimtare, deri në zgjedhjet e reja, të cilat kurrë nuk u mbajtën. Ai, me t'u zgjedhur kancelar, do ta uzurpojë pushtetin dhe do ta çojë Gjermaninë në humnerë. Gjatë luftës janë vrarë mbi 20 milionë gjermanë.

Në vitin 1939 do të nisë luftën më të tmerrshme në historinë e Evropës. Do të ndërtojë kampe përqëndrimi, në të cilat, pos tjerash, do të vriten miliona hebrenj. Më famëkeqi prej këtyre kampeve do të jetë "Auschwitz" në Poloni.

Në vitin 1945, kur disfata e tij u bë e paevitueshme, Hitleri do të urdhërojë që Gjermania të kallej dhe të shkatërrohet e tëra, por bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë nuk do ta dëgjojnë. Këtu do të veçohet Albert Speer, "arkitekti personal i Hitlerit", i cili do të burgoset në Spandau, burgun e njohur të Berlinit.

Më 30 prill të vitit 1945, teksa forcat e Armatës së Kuqe depërtonin në Berlin, Hitler, së bashku me gruan e tij Eva Braun, do të bëjë vetëvrasje. Trupi i tij do të digjet me naftë. Tek ekspertët anglezë, më vonë, do të vërtetojnë që trupi i djegur është ai i Adolf Hitlerit.

Pas Luftës së Dytë Botërore, emri i Hitlerit mbeti simbol i të së keqes, i urrejtjes dhe i shkatërrimeve. Kështu, një mori politikanësh u krahasuan me të. Së fundit, ishin dy të tillë: Saddam Hyseini, diktatori i Irakut dhe Slobodan Milosheviqi, kasapi i Ballkanit.

Për këtë shkak, procesi kundër Milosheviqit në Tribunalin e Hagës, më së shpeshti u krahasua me Procesin e Nurembergut kundër bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Adolf Hitlerit.

## PAVARËSIA ME REZISTENCË PAQËSORE: MOHANDAS K. GANDHI

Gandhi u lind më 1869 në vendin Gudzarhat, në Indinë Perëndimore. Si në rastin e shumicës së indasve, martesja e Gandhit ishte goditur shumë herët, kur ky ishte fëmijë. Për këtë shkak, ky u martua kur i kishte vetëm 13 vjet (ishte 13 vjeç dhëndër pra) me Kasturbai




Makanji. Nuk vonoi dhe Gadni i ri do të shkojë në Londër për të studiuar drejtësinë. Pas Anglisë, e cila në atë kohë sundonte me Indinë dhe me pothuaj gjysmën e botës, Gandhi shkoi në Afrikën e Jugut. Aty kishin gjetur punë shumë indas. Në Afrikë të Jugut Gandhi do të bëhet dëshmitar i eksploatimit të njeriut në baza raciale, sociale dhe të prejardhjes etnike. Duket që kjo përvojë do të jetë vendimtare për biografinë e tij të mëtejme. Për më tepër, pikërisht në Afrikë të Jugut, Gandhi do të nisë të kuptojë rëndësinë e rezistencës së padhunshme si formë të ndryshimit të gjendjes sociale dhe politike.

Indasit do ta quajnë Gandhin "Satyagraha" apo "fuqia e të së vërtetës". Edhe pse Gandhi i printe demonstratave paqësore, ai do të burgoset shpesh prej autoriteteve angleze, të cilat nisën të kuptojnë rrezikun e përhapjes së Lëvizjes së Gandhit në Afrikën e Jugut e më vonë edhe në Indi. Lëvizja e Gandhit intensifikohet posaçërisht në Indi, ku ky do të vihet në ballë të rezistencës e cila kishte për synim çlirimin e Indisë nga kolonializmi anglez.

Pas luftës shumëvjeçare, në vitin 1947, India arrin të bëhet shtet i pavarur. Ishte ky një rast i rrallë kur pavarësia e një shteti dhe çlirimi nga kolonializmi u arrit me lëvizje politike të padhunshme. Por, Gandhi do të ballafaqohet me probleme të reja kur shteti i sapokrijuar do të ndahet midis myslimanëve, të cilët do të krijojnë Pakistanin dhe hindusëve, që do të mbajnë Indinë. Dy muajt e fundit të jetës, Gandhi do t'ia kushtojë përpjekjeve për të ndalur dhunën në Kashmir, sepse edhe India edhe Pakistani pretendonin që Kashmiri i takon atyre. Dihet që sot e kësaj dite, Kashmiri është një problem i madh në raportet midis Indisë dhe Pakistanit, të cilat posedojnë edhe me armë bërthamore.

Në vitin 1948, Gandhi do të vritet nga një atentator teksa shetite kopshteve të New Delhit. Thuhet që vrasësi ka qenë një fanatik fetar i cili nuk i kuptonte porositë e Gandhit.

Emri i Gandhit sot e kësaj dite është sinonim për lëvizje paqësore të padhunshme dhe për përpjekjet që me metoda racionale të zgjidhen problemet e mëdha politike. Vepra dhe mendimi i tij kanë lënë gjurmë jo vetëm në Azi, por edhe në Evropë dhe në Amerikë, ku u shtua interesimi për trashëgiminë shpirtërore të kësaj pjese të botës. /Telegrafi/



## Rumania përballet me gjashtë akuzat, UEFA nis hetimet

NYON, 14 SHTATOR - Komisioni Disiplinor i UEFA-s ka nisur hetimet ndaj Rumanisë lidhur me pankartën dhe thirrjet "Kosova është Serbi". Ndeshja mes Rumanisë e Kosovës e vlefshme për kualifikimet për Kampionatin Evropian është ndërprerë për 50 minuta si pasojë e sjelljeve anti-sportive të huliganëve rumunë. Dy ditë pas takimit, Komisioni Disiplinor i forumit në Nyon nisi hetimet për rastin e Kosovës. Sipas burimeve të "GSP" pranë UEFA-s, në hetim do të analizohen gjashtë akuzat: Mesazhe provokuese me karakter fyes (pankarta të paligjshme, jo vetëm "Kosova

është Serbi", por edhe "Bessarabia është Rumani"). Mesazhe provokuese të karakterit fyes (thirrje të paligjshme). Sjellje raciste, ndezja e pishtarëve, hedhja e objekteve në fushë dhe bllokimi i zonave të aksesit publik, janë gjashtë akuzat me të cilat pritet të dënohet Rumania. Tre të parat janë më të rënda për Rumaninë, nëse shpallen fajtorë, rrezikojnë të luajnë në shtëpi me dyer të mbyllura, pa spektatorë, kundër Andorrës më 15 tetor, madje edhe kundër Zvicrës më 21 nëntor, ndeshjen e fundit të kampionatit evropian të Gjermanisë.



## Aro Muriq: Gjithmonë kënaqësi të luash për Kosovën, do t'ua shpaguajmë besimin



PRISHTINË, 14 SHTATOR - Portieri i Përfaqësueses së Kosovës, Arijanet Muriq ka reaguar me anë të postimit në rrjetet sociale, pas kritikave të shumta të ekipit pas humbjes së Kosovës nga Rumania. Kosova u mposht 2-0 nga Rumania në "Arena Nationale" në kuadër të Grupit I për eliminatorët e Euro 2024. Megjithatë, pati shumë tensione dhe ndërprerje për gati një orë shkak i banerit të shfaqur nga tifozët rumun, ku shkruante "Kosova është Serbi". Përveç kësaj, lojtarët e

Kosovës u kritikuan shumë pas humbjes, por portieri Muriq, i cili ishte nga të paktët që u lëndua, ka reaguar në profilin privat në "Instagram", duke thënë se është gjithmonë kënaqësi të luash për Kosovën. Ai shtoi se ekipi mëson vazhdimisht dhe do të rikthehet edhe më i fortë, për t'ua shpëruar të gjithëve besimin. "Gjithmonë kënaqësi për të luajtur për këtë vend, Faleminderit për mbështetjen, të gjithë ishit të mrekullueshëm", ka shkruar fillimisht Muriq në profilin e

tij. "Ne përqendrohemi te futboli, edhe nëse është i vështirë në rrethana si dje! Ecja përpara, gjithçka në të cilën mund të fokusohemi është të edukojmë brezin e ardhshëm dhe t'i lëmë paraqitjet tona në fushë të kapërcejnë çdo pengesë!. Jemi një skuadër e re e shkëlqyer, vazhdimisht mësojmë dhe besoj se do të rikthehemi më të fortë me më shumë zjarr dhe do të luftojmë për t'ua shpëruar të gjithë atyre që kanë besuar tek ne", ka përfunduar shkrimin e tij portieri i Kosovës.

## Ndeshja Shqipëri-Çeki, mbi 200 mijë kërkesa për bileta

TIRANË, 14 SHTATOR - Nëse në gusht entuziazmi ishte i madh, tani është kthyer në ethe. Kombëtarja shqiptare ka krijuar një iluzion të fortë tek tifozët se është shumë pranë finaleve të Evropianit 2024, dhe kjo ka bërë që kërkesa për bileta për ndeshjen e radhës të jetë përtej çdo imagjinate. Në 12 tetor kuqezinjët luajnë ndaj Republikës Çeke në Tiranë, dhe burime në Federatën Shqiptare të Futbollit tregojnë se interesimi për të qenë në

"Arenë" është tepër i madh. Sipas këtyre burimeve, kërkesa është afërsisht sa dhjetëfishi i kapacitetit të stadiumit kombëtar, që do të thotë për mbi 200 000 bileta. Jo vetëm kaq, por siç është normë në Shqipëri, nuk mungojnë kërkesa nga institucionet shtetërore, nga trupi diplomatik dhe nga kompani të fuqishme private. E gjitha kjo ka bërë që Federata të mos vendosë ende t'i nxjerrë në shitje "hyrëset" për në Arenë, proces që besohet se

do të jetë vetëm online. E njëjta gjë ndodhi edhe për ndeshjen me Poloninë, kur asnjë biletë nuk u shit fizikisht në biletarinë në stadium. Siç ndodh në rastet kur kombëtarja fiton, pritet që në "Arenë" të jetë trupi diplomatik, por edhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa biletat besohet se do të dalin në shitje ditët e ardhshme. Kombëtarja është e para në grupin E me 10 pikë në 5 ndeshje, ndërsa Çekia është e dyta me 8 pikë në 4 sfida.



## Gjyqtarë nga Kosova do të ndajnë drejtësi në Botërorin e futsallit

Prishtinë, 14 shtator - Treshja e gjyqtarëve kosovarë, Besar Beçiri, Besart Ismajli dhe Florentina Kallaba, do ta

ndajnë drejtësinë në ndeshjen tejet të rëndësishme në kuadër të Grupit B në "Elite Round", për kualifikimet e

Kupës së Botës në futsal. Ata janë deleguar nga UEFA në ndeshjen Belgjikë - Ukrainë, falë vlerësimit të mirë në

ndeshjet e deritashme në të cilat janë paraqitur. Kjo ndeshje zhvillohet të premten në orën 20:00.



## Fury rrezikon titullin, WBC mund t'ia heqë në rast se nuk e mbron atë brenda vitit

LONDËR, 14 SHTATOR - Stërvitja që boksieri britanik Tyson Fury për sfidën e tij të ardhshme me ish-kampionin e UFC-së, Francis Ngannou, mund të ndërpritet nga një duel i mundshme për titullin kampion të kategorisë WBC. "Mbreti Cigan" do të përballet me Ngannou më 28 tetor në Riad, por WBC me sa duket

po mendon për një duel të vërtetë boks. "Daily Star" raporton se një duel për titull me Anthony Joshua ose Deontay Wilder mund të jetë detyra e radhës e Fury. 35-vjeçari e ka mbrojtur tashmë rripin WBC në tre raste që kur e mori atë nga Wilder në vitin 2020, me sfidën më të fundit nga Derek Chisora, që u

zhvillua në fund të vitit të kaluar. Pritet që së shpejti të zhvillohet një përballetje "kokë më kokë" midis Joshua dhe Wilder për të vendosur se kush do të përballet me Fury vitin e ardhshëm. Fitorja e fundit e Joshua kundër Robert Helenius ka mbajtur të gjalla shpresat e tij për të rifituar titujt e tij dhe për të

krijuar luftën e mundshme me Wilder. Një sfidë britanikësh, që përfshin Fury dhe Joshua, është përfolur prej kohësh, por ende nuk është realizuar. Ndërsa Wilder është përballet me Fury në tre raste, duke humbur dy takimet më të fundit pas barazimit të tyre në 2018. Amerikani nuk ka luftuar që



kur mundi edhe Helenius në tetor 2022.

## Luiza Gega përfaqëson Shqipërinë në Olimpiadë

PARIS, 14 SHTATOR - Më pak se një vit nga Olimpiada "Paris 2024" Shqipëria endet nëpër aktivitetet ndërkombëtare për të grumbulluar pikët e nevojshme që të kualifikojë sportistët për në këtë aktivitet madhor, më i madhi i sportit në të gjithë Botën. Por pavarësisht kësaj, kuqezinjët olimpist kanë mundur të kualifikojnë vetëm 1 sportiste, Luiza Gega, kampionia e Evropës dhe pjesëmarrëse dinjitoze në Botërore dhe në çdo aktivitet ku merr pjesë, që nga korriku zyrtarisht e kualifikuar në Paris 2024. Sportisti tjetër në tentativë për t'u kualifikuar është Izmir Smajlaj prej shumë muajsh i dëmtuar dhe në hapat e para të rifillimit të stërvitjes, do të tentojë deri në fund për kualifikimin, pasi atletika do të ketë aktivitetet deri në maj, shanse për kualifikim, edhe pse atletika gjithësesi do ta ketë një ftesë për të çuar edhe një tjetër sportist veç Luiza Gegës. Ndërkohë peshëngritja, sporti ynë i traditës që prej vitesh e dekadash na ka dhuruar medalje për momentin është jashtë pritshmërive dhe kualifikimit, asnjë sportist të kualifikuar edhe pse ka ende aktivitetet thonë protagonistët dhe



bashkë me to edhe shpresë pavarësisht rezultateve të fundit në Arabinë Saudite, ku Qerimaj dhe Calja u renditën në vendet 7 dhe tetë në peshën 81 kg që nuk është një peshë Olimpikë, për më tepër që ky me gjasë kjo do të jetë dhe olimpiada fundit e këtij sporti, pasi në 2028-n është jashtë për momentin. Shpresat mbeten për kualifikim tashmë tek gjimnastika me gjimnastin rus Matvei Petrov që me gjasë do t'ja dalë të kualifikohet apo me dy sportistët me origjinë nga çëçenia, Abakarov dhe Dudaev, por që garojnë për Shqipërinë. Sporti tjetër që merr festa për

Olimpiadë është noti, ku do të kemi ndoshta si në të shkuarën 2 ftesa për dy sportist, për të formuar një ekip olimpik të projektuar për 6 apo 7 sportist, nga këta shumë pak shqiptarë, dhe nga këto pak shqiptarë, vetëm një të kualifikuar për momentin. Ndoshta është ende shpejt për të thënë, por askush nuk e nxitoi Luizën të kualifikohet kaq shpejt, ashtu si nuk i pengoi të tjerët të ishin kualifikuar, por niveli në rënie, do të na lë deri në frymën e fundit të shpresojmë tek pikët e kualifikimit, për ndryshe, ashtu sikurse në dasmë, të na ftojnë për Paris 2024-n.

## Bonucci shpërthen kundër Juves: Më turpëruan

TORINO, 14 SHTATOR - Mllëf dhe emocion. Leonardo Bonucci, në një intervistë për "Sportmediset", thyen heshtjen dhe tregon të vërtetën e tij në lidhje me largimin e bujshëm nga Juventus. Ndryshe nga se është folur në media, Bonucci ka një tjetër version tekta sulmon drejtuesit e "Zonjës së Vjetër" dhe trajnerin Max Allegri: "Kam lexuar e dëgjuar gjëra të pavërteta nga Juve dhe trajneri. Nuk është e vërtetë që në tetor apo shkurt më kanë komunikuar që nuk bëj pjesë në planet e klubit dhe



se dëshironin që në fund të sezonit të ndërprisnim bashkëpunimin. Përkundrazi, në fund të muajit maj i shpreha vullnetin tim se mund të

pranoja faktin që të isha zgjedhja e katërt apo e pestë në mbrojtje". "Nuhata diçka që nuk shkante, më pas më 13 korrik, Giuntoli dhe Manna erdhën në shtëpinë time dhe më komunikuan se nuk do të isha pjesë e grupit dhe se prezenca ime do të pengonte rritjen e ekipit. Ky ishte një turpërim për mua pas 500 ndeshjeve që kam zhvilluar me fanellën bardhezi. Më bëhet qejfi vetëm për mbështetjen e madhe që mora, edhe nga lojtarët aktual të Juventusit", u shpreh ndër të tjera Bonucci.

### SHKURT

#### Kasami zyrtarizohet te Sampdoria

Pajtim Kasami është transferuar tek skuadra e Sampdorias si lojtar i lirë pasi i përfundoi kontrata me klubin Olympiacos. Mesfushori me prejardhje shqiptare ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin nga Italia. Lajmin e ka bërë të ditur vetë klubi në rrjetet sociale. "Pajtim Kasami është lojtar i Sampdorias. Mesfushori ka kontratë deri më 30 qershor 2024", thuhej në njoftimin e klubit. 31-vjeçari ka luajtur edhe për klube të tjera si FC Basel, FC Luzern, Fulham, Nottingham Forest, Fc Sion, Palermo FC, Olympiacos.

#### Broja mund të kthehet në fushë të dielën

Sinjale pozitive për Armando Brojën te skuadra e Chelseat. Sulmuesi shqiptar pësoi një dëmtim të ashpër dhjetorin e kaluar dhe kreu një operacion që e ka mbajtur larg fushave deri më sot. Numërimi mbrapsht ka filluar për Armando Brojën, pasi mediat angleze raportojnë se sulmuesi kuqez i tashmë është kthyer në stërvitje me ekipin e parë të Chelseat dhe të dielën pritet të hidhet në fushë, ndoshta pak minuta nga fundi i ndeshjes. Trajneri Pochettino ka besim te Armando Broja, pasi ishte vetë trajneri argjentinas i cili refuzoi të gjithë ofertat e ardhura në drejtim të tij. Pochettino dëshiron të provojë Brojën në fushën e lojës dhe shansi mund të jetë të dielën ndaj Bournemouth.

#### Maguire: Dua të luftoj për vendin tim te Unitedi

Harry Maguire ka folur për situatën në të cilën gjendet në klubin e tij, Manchester United. "Katër javët e para ishin të vështira sepse ishte një ndeshje në javë dhe trajneri nuk më përzgjedhi, por ne kemi shumë ndeshje që vijnë tani dhe jam i sigurt se do të luaj shumë ndeshje", ka deklaruar lojtari i "Dajve të Kuq". Anglezi u shpreh se do të luftojë për një vend titullar në formacionin e United. "Jam i sigurt se historia vjen tek unë – pasi dua të luaj lojëra, dua të luaj futboll dhe do të luftoj për të", ka thënë Maguire. Ndërsa ai komentoi edhe për transferimin e tij në West Ham United që nuk ndodhi. "Ne thjesht nuk arritëm në një marrëveshje. Manchester United ishte i lumtur që unë qëndrova dhe unë isha i lumtur të luftoja për vendin tim. Sa herë që të stërvitem apo të luaj, do të jap gjithçka", shkruan Fabrizio Romano. Harry Maguire është pjesë e Unitedit që nga viti 2019, i cili erdhi nga Leicester City për 87 milionë euro.

## Ferdinand: Ronaldos iu vodh një 'Top i Artë', ai i fituar nga Modriqi

Rio Ferdinand ka pohuar se Cristiano Ronaldo u privua nga fitimi i një Topi të Artë në karrierën e tij dhe se ishte në vitin 2018, kur mesfushori i Real Madridit dhe kapiteni i kombëtares kroate, Luka Modriqi u shpall më i miri në botë. Sipas tij, më pas është bërë një padrejtësi dhe portugezit i

është grabitur një njohje e madhe. Ish-futbollisti i famshëm anglez po i përgjigjej një pyetjeje për "Topin e Artë" dhe krahasimet mes Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos, rivalë të mëdhenj dhe një dyshe që shumëkush pretendon se duhet quajtur më e mira në botë. I pyetur se kush ka më

shumë "Topa të Artë", Ferdinand befasoi me përgjigjen e tij: "Messi. Shtatë me pesë. Ronaldo u vodh në vitin kur Modriqi fitoi". Në vitin 2018, Modriqi i dha fund mbretërimit të Messit dhe Ronaldos, Para se të fitonte "Topin e Artë" dhe t'i jepte fund dominimit dhjetëvjeçar të

Messit dhe Ronaldos, të cilët alternonin si pushtues të tij, Modriqi u shpall lojtari më i mirë i Kupës së Botës, UEFA e shpalli atë futbollistin më të mirë në Evropë dhe FIFA më të mirin në botë. Në vitin 2018, ai fitoi disa tituj me Realin, duke përfshirë edhe Ligën e Kampionëve. Ky ishte trofeu i tij i katërt i tillë. Ai u

bë gjithashtu nën-kampion i botës me Kroacinë. Në vitin 2018, Modriqi mori 753 pikë në votimin për "Topin e Artë". Cristiano Ronaldo, i cili ishte bashkëlojtari i tij në Real atë sezon dhe shënoi 44 gola dhe tetë asistime në 44 ndeshje, përfundoi i dyti në votim me 478 pikë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 972/1  
Datë: 14.09.2023

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institutit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPAR-së, shpallë këtë:

**K O N K U R S**  
